EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5716
E hënë, 4 mars 2019
çmimi 0.40 €

Pacolli: Presim njohje edhe nga 19 shtete të tjera anëtare të OBI-t

FAQE 3

Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", BLERIM LATIFI FAQE 4-5

TAKSA ËSHTË KTHYER NË INSTRUMENT TË GARËS SË BRENDSHME POLITIKE

Këshilltari i kryeparlamentarit Kadri Veseli, Blerim Latifi, ka bërë me dije se taksa ndaj produkteve të Serbisë është kthyer në instrument të garës së brendshme politike. Ai ka thënë se tash flitet poshtë e lartë kush humb e kush fiton vota nga loja me taksën dhe kjo, sipas tij, përbën degradim.

Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Latifi ka thënë se vendosja e taksës ndaj Serbisë ka qenë reagim i drejtë ndaj agresionit diplomatik që Serbia kishte ndërmarrë ndaj Kosovës. Megjithatë, ai thotë se kjo nuk do të thotë të barrikadohemi në pozicionin që kemi marrë. Latifi ka thënë se duhet kërkuar rrugëdalje për çdo situatë dhe, sipas tij, rrugëdaljet gjithmonë ekzistojnë. Ai ka mohuar që Qeveria të bjerë për shkak të taksës. "Qëndrimi i kryetarit Veseli ka qenë dhe mbetet i qartë: Qeveria e Kosovës nuk do të bjerë për shkak të taksës", ka thënë Latifi

LIGJVËNËSIT SABOTOJNË QËLLIMISHT PROJEKTLIGJET EKONOMIKE

FAQE 9

Një mori projektligjesh të çështjeve ekonomike vazhdojnë të sabotohen në seancat plenare të Kuvendit duke mos hyrë në votim. Përfaqësues të organizatës "Konsumatori" dhe të Odës së Afarizmit kanë thënë për gazetën "Epoka e re" se neglizhimi i projektligjeve dhe çështjeve ekonomike nga ana e ligjvënësve është i qëllimshëm. Kurse

Artan Murati nga KDI-ja ka pohuar se duhet të merren masa ndëshkuese për deputetët që nuk marrin pjesë në seanca

LAJMI I FUNDIT

Shqiptarët fitojnë komunën e Tuzit

FAQE 2

AKTUALE

FOSHNJËRIA E POLITIKËS SONË F. 10

Shkruan: Prof. Ass. Dr. Sabri KIÇMARI

IMPRESIONE NGA DITA E PARË E SAMITIT TË DIASPORËS F. 10

Prof. Lisen BASHKURTI

VEHBI NAZIFI ZGJEDHET KRYETAR I DEGËS SË PDK-së NË DRAGASH F. 10

EKONOMI

PËR DY MUAJ DOGANA MBLEDH 6.6 PËR QIND MË SHUMË TË HYRA F. 9

NGA MAJI KOSOVA DHE SHQIPËRIA NUK DO TË KENË MË ROMING F. 9

KULTURË

LIBRI I LUFTËS SË KOSOVËS F. 12

Berat ARMAGEDONI

SPORT

ADEMI, SERBISË: VEÇ FFK-ja MUND TË ORGANIZOJË GARA NË KOSOVË F. 18

LLAPI DHE FERONIKELI SULMOJNË FFK-NË DHE KRYETARIN ADEMI F. 18

LLAPI DHE FERONIKELI SULMOJNË FFK-NË DHE KRYETARIN ADEMI F. 19

RENOVA PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht –Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · ÇUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SHA
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan , Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Ziadin Sela mbështet Blerim Rekën për president të Maqedonisë së Veriut

Shkup, 3 mars - Kryetari i Aleancës për Shqiptarët (ASh), Ziadin Sela, ka dhënë nënshkrimin e tij për kandidatin e vetëm shqiptar për president të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Blerim Reka. "Mbështetje e madhe, radhë të gjata qytetarësh para zyrave të Komisionit Zgjedhor në Strugë, tek objekti i Ministrisë së Drejtësisë, dhoma 14, sipër Postës së vjetër", ka shkruar Sela në llogarinë e vet në "Facebook".

Shqiptarët duke pritur fitoren në Komunën e Tuzit

Partitë shqiptare shpresojnë në fitoren e kandidatit të tyre të përbashkët, Nik Gjeloshaj, për kryetar të Komunës së Tuzit. Sondazhet e fundit tregojnë për një fitore të ngushtë të koalicionit shqiptar me mbështetjen e rreth 45 % të elektoratit

Prishtinë, 3 mars - Të dielën janë mbajtur zgjedhjet vendore për Komunën e Tuzit. Partitë shqiptare janë bërë bashkë për ta mbështetur Nik Gjeloshajn për kryetar të kësaj komune. Gara më e fortë zgjedhore ka qenë në mes të koalicionit të forcave politike shqiptare "Malësia na bashkon" dhe Partisë Demokratike Socialiste të presidentit malazias Milo Gjukanoviq. Edhe sondazhet e fundit tregojnë për një fitore të ngushtë të koalicionit shqiptar me mbështetjen e rreth 45 % të elektoratit, ndërkohë si parti e dytë sondazhet nxjerrin Partinë Demokratike Socialiste të Gjukanoviqit.

Të gjitha vendvotimet janë hapur në orën 7:00 të mëngjesit.

Në këto zgjedhje kanë marrë pjesë pesë lista dhe një koalicion (koalicioni i subjekteve politike shqiptare), ndërsa të drejtë vote kanë pasur 11 904 qytetarë të cilët do të zgjedhin 32 këshilltarë në kuvendin e ardhshëm lokal të këtij qyteti.

Koalicioni i subjekteve politike shqiptare "Forumi shqiptar" ka garuar nën numrin rendor 5. Interesimi për pjesëmarrje në votime ka qenë tejet i madh, veçanërisht i medieve shqiptare nga Shqipëria dhe Kosova. Kjo konsiderohet si ditë historike për shqiptarët që banojnë në Mal të Zi, pasi për herë të parë në Tuz votohet për kreun e komunës.

Thirrjet që shqiptarët të votojnë të gjithë për kandidatin e koalicionit "Malësia na bashkon" nuk kanë munguar ditët e fundit nga Tirana, por edhe jashtë kufijve të Shqipërisë.

Përfaqësuesit shtetërorë dhe partiakë në Kosovë dhe Shqipëri kanë ftuar votuesit shqiptarë në Komunën e Tuzit që të dielën ta votojnë Nik Gjeloshajn për kryetar të kësaj komune. Ata kanë thënë se votimi i kandidatit të përbashkët shqiptar për kryetar të Tuzit do të ketë ndikim për të ardhmen e kësaj komune për katër vjetët e ardhshëm.

Kandidati Nik Gjeloshaj ka thënë se Malësia do të triumfojë në Tuz. "Procesi ka filluar në mëngjes, ku janë evidentuar edhe disa probleme teknike, ndërsa çdo dy orë bëhet ristartimi i kompjuterit që bën identifikimin e votuesve. Qëllimi ynë është që kjo të jetë një ditë feste për Malësinë, ndaj bëjmë apel që të kemi pjesëmarrje masive në këtë vendim historik. Të gjitha pengesat nuk mund të ndalin procesin, që është triumfi i Malësisë", tha kandidati Nik Gjeloshaj.

LAJMI I FUNDIT

Shqiptarët fitojnë komunën e Tuzit

Sipas të dhënave preliminare nga shtabi i koalicionit shqiptar, 80 për qind e zonave malore në Tuz kanë votuar pro shqiptarëve në zgjedhjet e së dielës në këtë komunë. Edhe mediet malazeze kanë shkruar se kandidati i përbashkët i koalicionit të tri partive: Alternativa Shqiptare, Lidhja Demokratike Shqiptare dhe Unioni Demokratik Shqiptar, Nik Gjeloshaj, ka fituar shumicën e votave në zgjedhjet lokale të Tuzit.

'Blindohet' Parlamenti, kamera sigurie në çdo cep para protestës

Tiranë, 3 mars - Frika për një përshkallëzim të dhunës në protestën e radhës të opozitës para Parlamentit ka detyruar policinë të marrë masa paraprake. Nesër (e martë), pavarësisht se policia nuk ka dhënë leje, opozita ka vendosur të dalë të protestojë ashtu siç bëri të enjten e shkuar, ku nuk munguan incidentet, dhuna, gomat e djegura dhe gazi lotsjellës. Bëhet fjalë për masa shtesë ku, ndër të tjera, orët e fundit janë instaluar kamera me rezolucion të lartë që mundësojnë identifikimin e protestuesve me anë të zoomit.

Janë gjashtë kamera sigurie që janë instaluar nga Policia e Shtetit në vende të ndryshme për të pasur një panoramë sa më të gjerë të aktivitetit të protestuesve. Tri kamera sigurie janë vendosur në sheshin pranë Parlamentit dhe qendrës tregtare, dy kamera janë të fiksuara, ndërsa një e lëvizshme do t'i monitorojë të gjitha lëvizjet në këtë pjesë të sheshit. Një tjetër kamerë është vendosur në pallatin që ndodhet ngjitur Parlamentit, e cila ka një pamje të qartë të protestuesve që vijnë nga rruga e Elbasanit. Një tjetër kamerë është vendosur në hyrje të kalasë së Tiranës për t'i monitoruar edhe lëvizjet e mundshme të protestuesve në këtë zonë.

Mes të tjerash, policia ka në dispozicion edhe kamerat e bizneseve aty pranë, të cilët në çdo kohë mund të hyjnë në punë për të identifikuar persona të dhunshëm gjatë protestës apo incidente të mundshme gjatë saj. Ashtu si në protestën e shkuar, opozita ka angazhuar të gjitha strukturat dhe simpatizantët e saj për të manifestuar para Kuvendit. Ndërkohë që seanca plenare pritet të nisë në orën 10:00, policia ka vendosur ta ruajë rendin dhe institucionin me rreth 1 000 policë dhe agjentë civilë në terren.

Kryemadhi: Në fund të majit, zgjedhje të parakohshme

Tiranë, 3 mars - Monika Kryemadhi mblodhi të dielën Komitetin Drejtues Kombëtar të LRI-së, duke dhënë porosi të rëndësishme përpara zgjedhjeve të parakohshme që, sipas saj, do të zhvillohen në fund të muajit maj. "Të jeni të bindur se në fund të majit Shqipëria do të shkojë në zgjedhje të parakohshme", u shpreh Kryemadhi.

Kryetarja e LSI-së kërkoi nga të rinjtë e forumit të saj që të bëhen gati pasi protestat do t'i pasojë një proces zgjedhor me shumë rëndësi për Shqipërinë, që do ta largojë Edi Ramën.

Teksa foli për tubimet e njëpasnjëshme të PD-së dhe LSI-së, Kryemadhi theksoi se ato nuk kanë kontekst politik, por ndikohen nga njerëzit që dalin në shesh për hallet e tyre. "Protesta nuk është politike. Njerëzit nuk dalin as për Lulin e as për Monikën. Njerëzit në shesh kanë dalë për hallet e tyre, ashtu si protesta e studentëve për çmimet e taksat e larta, kushtet e mjerueshme e shumë problematika të tjera që sollën një protestë madhështore. Pakënaqësia nuk ishte as opozitare, as nga një grusht njerëzish, por e qindra e mijëra studentëve që i dhanë një mësim të mirë jo vetëm opozitës, por të gjithë atyre njerëzve që nuk janë dakord me reformat e qeverisë e diktaturën dhe realitetin e hidhur e më poshtërues që kanë kaluar shqiptarët që nga viti 1990", tha Kryemadhi.

EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

Pacolli: Presim njohje edhe nga 19 shtete të tjera anëtare të OBI-t

Pas votimit të rezolutës për Kosovën nga 57 shtete anëtare të Organizatës për Bashkëpunim Islamik (OBI), e cila bën thirrje për njohjen e shtetit të Kosovës, ministri i Punëve të Jashtme, Behgjet Pacolli, ka thënë se tashme 38 shtete anëtare të OBI-t e njohin Republikën e Kosovës, ndërkaq ka theksuar se pret që edhe 19 shtete anëtare të kësaj organizate, të cilat ende nuk e kanë marrë këtë vendim, ta bëjnë këtë së shpejti

EPOKA E RE Faton DËRMAKU

Abu Dhabi, 3 mars - Zëvendëskryeministri dhe ministri i Punëve të Jashtme i Republikës së Kosovës, Behgjet Pacolli, e ka mirëpritur dhe përshëndetur aprovimin me unanimitet të plotë të Rezolutës për Kosovën nga 57 shtetet anëtare të Organizatës për Bashkëpunim Islamik (OBI), në sesionin e 46 të Këshillit të Ministrave të Jashtëm, në kryeqytetin e Emirateve të Bashkuara Arabe, Abu Dhabi.

"Mirënjohës OBI-t dhe shteteve anëtare për miratimin me unanimitet të Rezolutës, duke thirrur shtetet e saj anëtare që ta njohin Kosovën dhe mbështesin anëtarësimin e saj në organizata ndërkombëtare. Kosova do ta vazhdojë angazhimin e saj me OBI-n dhe do t'i rrisë edhe më tej lidhjet", ka thënë ministri i Jashtëm, Behgjet Pacolli, pas aprovimit të kësaj rezolute. "Tashmë 38 shtete anëtare të OBI-t e njohin Republikën e Kosovës. Ne presim që edhe 19 shtetet anëtare të kësaj organizate, të cilat ende nuk e kanë marrë këtë vendim, ta bëjnë këtë së shpejti. Rezoluta bën thirrje pikërisht për këtë dhe presim lëvizje të reja në këtë drejtim", është shprehur numri dy i Qeverisë së Kosovës.

Gjatë pjesëmarrjes dhe përfaqësimit të Kosovës në sesionin e 46 të Këshillit të Ministrave të Jashtëm në Abu Dhabi, ministri i jashtëm, Behgjet Pacolli, ka takuar shumicën e homologëve të vet nga 57 shtetet anëtare që morën pjesë në këtë takim dhe që vijnë nga katër kontinente të ndryshme të botës.

Kosova dhe Kolumbia kanë vendosur marrëdhënie diplomatike

Zëvendëskryeministri dhe ministri i Punëve të Jashtme i Republikës së Kosovës, Behgjet Pacolli, e ka mirëpritur një letër të pranuar nga homologu i vet nga Republika e Kolumbisë, Carlos Holmes Trujillo Garcia, nëpërmjet së cilës ai njoftohet mbi dekretin për vendosjen e marrëdhënieve diplomatike në mes dy shteteve, veprim ky që mundëson komunikimin e përhershëm të nivelit më të lartë në mes dy vendeve me shkëmbimin edhe të ambasadorëve.

Kjo letër pason pas një takimi që kryediplomati kosovar, Pacolli, kishte zhvilluar me ministrin e Jashtëm të Kolumbisë, Carlos Holmes Trujillo García, në pjesën e parë të muajit shkurt në Uashington D. C. "Pas takimit me ministrin e Jashtëm të Kolumbisë, Carlos Holmes Trujillo García, muajin e kaluar, Kosova dhe Kolumbia kanë vendosur marrëdhënie diplomatike nëpërmjet shkëmbimit të ambasadorëve. Kosova do ta hapë ambasadën e vet me qëndrim në Bogota dhe Kolumbia do të emërojë ambasador jorezident nga Italia", ka thënë Pacolli.

Nëpërmjet hapjes së ambasadës rezidente në Bogota, Republika e Kosovës synon mbulimin dhe përfaqësimin jorezident diplomatik edhe në shtete të tjera në atë kontinent.

McAllisteri i bën thirrje Kosovës që ta pezullojë taksën

Prishtinë, 3 mars (ER) - Një grup i eurodeputetëve, i kryesuar nga kryetari i Komitetit për Punë të Jashtme në Parlamentin Evropian, David McAllister, është takuar në fundjavë me zëvendëskryeministrin e Kosovës, Enver Hoxhaj.

Pas takimit, në një konferencë për media, McAllister i ka bërë thirrje Qeverisë së Kosovës që ta pezullojë taksën doganore prej 100 përqindësh ndaj mallrave të Serbisë dhe Bosnjë e Hercegovinës, në mënyrë që dialogu në Bruksel të vazhdojë. "Sipas pikëpamjes sonë, pezullimi i tarifës do të jetë rruga drejt suksesit. Ne kemi qenë shumë të qartë lidhur me këtë dhe kemi ripërsëritur mesazhin në këto dy ditë të qëndrimit në Prishtinë. Mes arsyeve të tjera, kjo është një shkelje e Marrëveshjes së CEFTA-s dhe, po ashtu, shkelje e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit. Prandaj, ne nuk besojmë se ky është vendimi i duhur dhe i drejtë", ka thënë McAllister.

I pyetur se a ta mbështeste një shkëmbim të mundshëm të territoreve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, e cila do të mund të dilte nga marrëveshja eventuale mes dy vendeve, McAllister ka pohuar se qëndrimi i Bashkimit Evropian dhe i tij personal është që për ta do të ishte e pranueshme një marrëveshje që bien dakord të dyja palët. "Lidhur me debatin për mundësinë e shkëmbimit të territoreve, Parlamenti Evropian vëren që debati lidhur me korrigjimin e kufirit, përfshirë dhe shkëmbimin e territoreve, Parlamenti Evropian nënvizon natyrën shumetnike të Kosovës dhe të Serbisë dhe kjo gjendje shumetnike nuk duhet të hidhet poshtë dhe ajo duhet të mbrohet. Parlamenti Evropian konsideron se kjo marrëveshje do të jetë e pranueshme vetëm nëse për këtë ka pajtim të dyanshëm, duke marrë parasysh stabilitetin në tërësi në rajon dhe të drejtën ndërkombëtare. Ky është pozicioni i Bashkimit Evropian dhe imi. Por, e kuptoj se kanclearja gjermane (Angela Merkel) ka shprehur se ka opinion paksa më ndryshe", ka thënë McAllister.

Bashkimi Evropian, edhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, po kërkojnë nga Qeveria e Kosovës ta pezullojë taksën e cila është në fuqi që nga nëntori i vitit të kaluar. Por, kryeministri Ramush Haradinaj po këmbëngulë që kjo tarifë do të jetë në fuqi derisa Serbia ta njohë pavarësinë e Kosovës.

Ndërkaq zëvendëskryeministri Enver Hoxhaj ka thënë se në takim me eurodeputetët kanë folur për tri çështje: liberalizimin e vizave për qytetarët e Kosovës, dialogun me Serbinë dhe tarifën doganore. Sa i përket çështjes së liberalizimit të vizave, Hoxhaj ka thënë se ka vërejtur se pas zgjedhjeve në Bashkimin Evropian, që pritet të mbahen në maj, mund të krijohet një rrethanë e re. "E fitova një përshtypje që pas zgjedhjeve të Bashkimit Evropian, në maj të 2019-s, mund të krijohet një rrethanë e re në verën e këtij viti, që të merret një vendim pozitiv", ka thënë Hoxhaj.

Flet për "Epokën e re", Blerim Latifi

Taksa është kthyer në instrument

Këshilltari i kryeparlamentarit Kadri Veseli, Blerim Latifi, ka bërë me dije se taksa ndaj produkteve të Serbisë është kthyer në instrument të garës së brendshme politike. Ai ka thënë se tash flitet poshtë e lartë kush humb e kush fiton vota nga loja me taksën dhe kjo, sipas tij, përbën degradim. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Latifi ka thënë se vendosja e taksës ndaj Serbisë ka qenë reagim i drejtë ndaj agresionit diplomatik që Serbia kishte ndërmarrë ndaj Kosovës. Megjithatë, ai thotë se kjo nuk do të thotë të barrikadohemi në pozicionin që kemi marrë. Latifi ka thënë se duhet kërkuar rrugëdalje për çdo situatë dhe, sipas tij, rrugëdaljet gjithmonë ekzistojnë. Ai ka mohuar që Qeveria të bjerë për shkak të taksës. "Qëndrimi i kryetarit Veseli ka qenë dhe mbetet i qartë: Qeveria e Kosovës nuk do të bjerë për shkak të taksës", ka thënë Latifi

EPOKA E RE **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 3 MARS - Këshilltari i kryetarit të Kuvendit të Kosovës, Kadri Veselit, Blerim Latifi, ka thënë të dielën se taksa nuk do të jetë shkaktare për rrëzimin e koalicionit qeverisës. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka theksuar se ky është qëndrim i palëkundur i kryeparlamentarit Veseli. "Por kjo nuk do të thotë të barrikadohemi në pozicionin që kemi marrë dhe të mos qajmë kokën se çfarë po bëjnë të tjerët, qofshin ata kundërshtarët tanë, qofshin miqtë tanë. Duhet kërkuar rrugëdalje për çdo situatë dhe rrugëdaljet gjithmonë ekzistojnë. Jeta është plot mundësi. Politika, po ashtu. Veprimet politike e shtetërore duhet të gjykohen nga efektet e tyre praktike, jo nga emocionet e patriotizmit folklorik", është shprehur ai, duke shtuar se qëndrimet e zyrtarëve të lartë amerikanë janë të qarta dhe, sipas tij, ata konsiderojnë se taksa paraqet pengesë për avancimin e dialogut Kosovë - Serbi.

Latifi ka thënë se veprimet politike dhe shtetërore duhet të gjykohen nga efektet e tyre praktike, jo nga emocionet e patriotizmit folklorik. "Një ndër defektet kryesore të partive politike në Kosovë është se gjithçka e shohin nga perspektiva e ngushtë e interesit elektoral. Kjo, fatkeqësisht, është duke ndodhur edhe me taksën. Vendosja e taksës ndaj Serbisë ka qenë reagim i drejtë ndaj agresionit diplomatik që Serbia kishte ndërmarrë ndaj Kosovës gjatë gjithë vitit të kaluar. Tash është tjetërsuar domethënia e saj. Tash flitet poshtë e lartë kush humb e kush fiton vota nga loja me taksën. Kjo përbën degradim realisht, sepse nga instrument në funksion të shtetit, taksa është kthyer në instrument të garës së brendshme politike. Kush po e bën këtë? Lloji më i dëmshëm i njerëzve rreth liderëve politikë të vendit", ka deklaruar ai.

Përplasjet e fundit verbale në politikën e Kosovës, Latifi i sheh si përplasje mes atyre që mbështesin status quon dhe atyre që konsiderojnë se është momenti për të dalë prej saj. Ai ka theksuar se po punohet pak në vullnetin për ta unifikuar qëndrimin shtetëror. "E keqja themelore e këtyre përplasjeve është se po punohet pak në vullnetin për ta unifikuar qëndrimin shtetëror. Në këtë rast përjashtim bën kryetari i Kuvendit, Veseli, i cili në vazhdimësi ka bërë thirrje dhe ka investuar në gjetjen e një formule të bashkëveprimit institucional dhe politik", ka deklaruar Latifi.

"Epoka e re": *Z. Latifi, sërish zyrtarët e lartë amerikanë gjatë vizitës në Prishtinë kanë qartësuar sugjerimin e tyre për pezullimin e taksës. Si e keni parë vizitën dhe këshillat e tyre?*

Latifi: Qëndrimet e zyrtarëve të lartë amerikanë, të cilët kanë shtuar vizitat në Kosovë, janë të qarta. Ata konsiderojnë se taksa ndaj Serbisë, në gjendjen e saj ekzistuese, paraqet pengesë për avancimin e procesit të dialogut të Kosovës me Serbinë drejt finalizimit të tij. Po ashtu, është e qartë se Shtetet e Bashkuara të Amerikës e kanë përcaktuar si interes të tyre që mosmarrëveshjet e Kosovës me Serbinë të përfundohen sa më parë që është e mundur me anë të një formule afatgjatë, e cila u jep fund armiqësive mes dy vendeve. Kjo gjithsesi që është edhe interes i Kosovës. Në këtë kontekst, gjëja më e rëndësishme është fakti se Shtetet e Bashkuara të Amerikës vazhdojnë ta mbajnë vëmendjen e plotë për dhe rreth Kosovës. Shteti i Kosovës, para se gjithash, është projekt ndërkombëtar i Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe ky projekt ende nuk është përfunduar. Që kjo të ndodhë me sukses,

: të garës së brendshme politike

është e domosdoshme të ndiqet rruga që kemi ndjekur tash e 20 vjet: të qëndrojmë në koordinatat e vendosura nga ShBA-ja.

"Epoka e re": Çfarë duhet të bëjë Kosova tani?

Latifi: Ne jemi realisht në një situatë të vendnumërimit. Procesi i përmbylljes së subjektivitetit ndërkombëtar të shtetit ka ngecur në vend. Nuk ka më njohje nga shtetet e tjera. Shikoni edhe vetë termi 'lobim për njohje' që e përdorin diplomatët tanë mburravecë është bërë klishe dhe e ka humbur kredibilitetin. Nuk ka lëvizje drejt integrimit në OKB. Pesë vende të Bashkimit Evropian nuk na njohin si shtet dhe kjo praktikisht e bën të pamundur çdo avancim substancial të Kosovës në procesin e integrimeve evropiane. Shikoni çfarë ndodhi me liberalizimin e vizave. Nëse BE-ja si tërësi nuk të njeh si shtet, atëherë hyrja në të mbetet një utopi, asgjë më shumë. Në këtë situatë para nesh janë dy rrugë: ta zgjedhim vazhdimin e të jetuarit në këtë status quo, ose të përpiqemi të dalim prej saj. Unë besoj se Shtetet e Bashkuara të Amerikës e duan pikërisht rrugën e dytë dhe këtu qëndron arsyeja e angazhimit të saj kohën e fundit rreth Kosovës. Përplasjet e fundit verbale në politikën e Kosovës i shoh si përplasje mes atyre që mbështesin status quonë dhe atyre që konsiderojnë se është momenti të dalim disi prej saj. E keqja themelore e këtyre përplasjeve është se po punohet pak për ta unifikuar qëndrimin shtetëror. Në këtë rast, përjashtim bën kryetari i Kuvendit, Veseli, i cili në vazhdimësi ka bërë thirrje dhe ka investuar në gjetjen e një formule të bashkëveprimit institucional dhe politik.

"Epoka e re": *Dy zyrtarët e lartë amerikanë në takimet me liderët institucionalë të Kosovës kanë përmendur edhe hapat e tjerë që mund t'i ndërmarrë ShBA-ja ndaj Kosovës, duke përfshirë edhe largimin e trupave nga Kosova. A e ka Kosova luksin që, për shkak të kësaj takse, t'i lëndojë raportet strategjike me ShBA-në?*

Latifi: Raportet e Kosovës me Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë më shumë se strategjike. Janë raporte amësie. Shteti i Kosovës është produkt i ShBA-së dhe përderisa ende jemi në fazën e maturimit, mbështetja nga ShBA-ja është jetësore për ne. Kjo është diçka që dihet shumë mirë nga të gjithë, prandaj çdo hap ose veprim që krijon hendek në mes të Kosovës dhe ShBA-së mund të ketë pasoja të rënda për avancimin e mëtutjeshëm të Kosovës si shtet i pavarur dhe sovran. Sa iu përket masave ndëshkimore ndaj asaj që mund ta quajmë pa dëgjueshmëri ndaj amerikanëve, nuk besoj se këto masa mund të jenë ashtu siç u përfol gjatë javës së kaluar. U përmend edhe dislokimi i kampit ushtarak Bondsteel. Një gjë duhet ta kemi të qartë: trupat amerikane në Kosovë janë për popullin e Kosovës, për sigurinë e tij. Nuk janë këtu për politikanët e saj. Politikanët dhe pushteti vijnë e shkojnë, populli dhe shteti mbesin gjithmonë, prandaj edhe prania ushtarake amerikane do të mbetet.

"Epoka e re": *Keni thënë se taksa tani ka filluar të përdoret si instrument në luftën e brendshme politik. Kush po e bën këtë?*

Latifi: Një ndër defektet kryesore të partive politike në Kosovë është se gjithçka e shohin nga perspektiva e ngushtë e interesit elektoral. Kjo, fatkeqësisht, është duke ndodhur edhe me taksën. Vendosja e taksës ndaj Serbisë ka qenë reagim i drejtë ndaj agresionit diplomatik që Serbia kishte ndërmarrë ndaj Kosovës gjatë gjithë vitit të kaluar. Tash është tjetërsuar domethënia e saj. Tash flitet poshtë e lartë kush humb e kush fiton vota nga loja me taksën. Kjo përbën degradim realisht, sepse nga instrument në funksion të shtetit, taksa është kthyer në instrument të garës së brendshme politike. Kush po e bën këtë? Lloji më i dëmshëm i njerëzve rreth liderëve politikë të vendit.

"Epoka e Re": *Kush janë ata?*

Latifi: Servilët, lakenjtë, këshilltarët e këqij, puthadorët pa mendim politik dhe rezon shtetëror.

"Epoka e re": *Kohën e fundit PDK-ja ka paralajmëruar marrjen e disa veprimeve, nëse kryeministri Haradinaj vazhdon të insistojë në mbajtjen e taksës. Sa do të presë PDK-ja dhe z. Veseli në këtë drejtim?*

Latifi: Qëndrimi i kryetarit Veseli ka qenë dhe mbetet i qartë: Qeveria e Kosovës nuk do të bjerë për shkak të taksës. Ky është qëndrim i palëkundur. Prapa këtij qëndrimi ka vetëm arsye, absolutisht vetëm një: raporti që kemi me Serbinë, për asnjë moment, nuk bën të influencojë në stabilitetin e qeverisë dhe të qeverisjes në Kosovë. Arsyet e tjera që mund të përmenden janë spekulime të lira dhe, si të tilla, krejtësisht të pasakta. Por, kjo nuk do të thotë të barrikadohemi në pozicionin që kemi marrë dhe të mos qajmë kokën se çfarë po bëjnë të tjerët, qofshin ata kundërshtarët tanë, qofshin miqtë tanë. Duhet kërkuar rrugëdalje për çdo situatë dhe rrugëdaljet gjithmonë ekzistojnë. Jeta është plot mundësi. Politika, po ashtu. Veprimet politike dhe shtetërore duhet të gjykohen nga efektet e tyre praktike, jo nga emocionet e patriotizmit folklorik.

Rreth 100 mijë vendime gjyqësore nuk po zbatohen

Prishtinë, 3 mars - Numri i lëndëve në procedura gjyqësore në të gjitha gjykatat në vend është 400 mijë, por edhe rreth 100 mijë vendime që janë marrë nga gjykatat nuk po gjejnë zbatim. Avokati i Popullit, Hilmi Jashari, në një intervistë për "Ekonomia Online", ka thënë se zvarritjet e tejzgjatura të vendimeve gjyqësore janë tiparet kryesore që identifikojnë mosfunksionimin e sistemit gjyqësor në vend. "E drejta për qasje në gjykatë është në dispozitë kushtetuese dhe në pajtueshmëri të plotë me kërkesat dhe standardet ndërkombëtare në botë. Problemi që lind te kjo e drejtë është ajo që ne e quajmë administrim i drejtësisë që përkon me moszbatimin e vendimeve gjyqësore dhe zvarritjet e tejzgjatura të vendimeve gjyqësore. Këto janë dy tiparet kryesore që identifikojnë mosfunksionimin e sistemit gjyqësor në vend", ka thënë Jashari. Sipas tij, numri i lëndëve të paekzekutuara shkon në 100 mijë përderisa i gjithë numri i lëndëve në procedura gjyqësore është 400 mijë, e kjo diferencë, sipas Jasharit, është një e metë e sistemit gjyqësor në vend. "Në Kosovë numri i lëndëve në procedura gjyqësore është 400 mijë. Nëse prej këtij numri, 100 mijë afërsisht mbesin të paekzekutuara, është një e metë jashtëzakonisht e madhe e sistemit që shoqëria e Kosovës, gjithashtu edhe të gjitha autoritetet, do të duhej të organizoheshin të bënin diçka, sepse është e metë e madhe në gjithë sistemin i cili reflekton pastaj edhe në dobësinë e shtyllave të tjera të pushtetit dhe humbet besimi i qytetarëve në gjithë sistemin", ka thënë Avokati i Popullit, Hilmi Jashari.

Nga maji Kosova dhe Shqipëria nuk do të kenë më roming

Prishtinë, 3 mars - Tarifat e romingut në telekomunikim ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë do të largohen në muajin maj të këtij viti. Kështu ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" koordinatori kombëtar i të dy qeverive, Fatmir Limaj. Ai ka thënë se heqja e tarifave dhe shumë marrëveshje t` tjera të arritura më parë ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë janë në rrugë të mirë të zbatimit. "Ne, si Kosovë, jemi gati menjëherë ta zbatojmë romingun, por besoj se edhe Tirana shumë shpejt përmes vendimit të Qeverisë dhe Parlamentit do ta marr` atë vendim dhe në maj nuk do të kemi problem me romingun dhe do të zbatohet pastaj është çështja e patentëshoferëve që pothuajse është kryer. Te çështja e qarkullimit të lirë të qytetarëve duhet të jemi të kujdesshëm, duke respektuar obligimet që kemi me Bashkimin Evropian si dy vende", është shprehur Limaj.

Tarifa e romingut nënkupton telekomunikimin dhe shërbimin që qytetarët e përdorin në një vend tjetër nga një qendër e operatorit të telefonisë mobile. Këto tarifa janë kryesisht dyfish më të larta sesa ato që përdoren për telekomunikim brenda një shteti.

Kuvendi i Kosovës në qershor të vitit të kaluar kishte votuar një rezolutë për heqjen e tarifave të romingut në telekomunikim ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë. Edhe Bashkimi Evropian u ka kërkuar të gjitha vendeve të Ballkanit Perëndimor që ta heqin këtë tarifë si formë lehtësimi për komunikimet ndërmjet qytetarëve.

Agron Dida, ekspert për çështje të telekomunikacionit, pati thënë për "Radion Evropa e Lirë" se heqja e romingut në telekomunikim, ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë, është në dobi të qytetarëve dhe bizneseve.

Ky veprim, sipas Didës, do të duhej të zgjerohej edhe me vendet e tjera fqinje në mënyrë që të krijohet një situatë më e volitshme e komunikimit. "Duhet bërë çmos që diplomacia jonë të veprojë me partnerët e tyre në Shqipëri dhe të ecin përpara. Unë mendoj se vetëm interesat e operatorëve janë në pyetje këtu që nuk do të dëshironin të bënin këtë veprim, i cili është në dobi të qytetarëve dhe bizneseve. Kosova ka nevojë për komunikime me botën, e veçanërisht me Shqipërinë është në interes kombëtar dhe në çdo aspekt tjetër të bëhet një gjë e tillë", ka thënë ai.

Kosova dhe Shqipëria në mbledhjet e përbashkëta të dy qeverive ndër vite kanë nënshkruar marrëveshje të shumta, të cilat kishin për qëllim qeverisje të përbashkët strategjike me një vizion euroatlantik. Këto dy shtete kanë të nënshkruar një protokoll bashkëpunimi ndërqeveritar, i cili përfaqëson kornizën e plotë institucionale të marrëdhënieve ndërmjet këtyre shteteve në të gjitha fushat, duke filluar nga ekonomia e deri tek arsimi.

Por që, jo rrallëherë zbatimi i këtyre marrëveshjeve, thotë Fatmir Limaj, ka hasur në pengesa. "Ka qenë një praktikë e mirë kur kanë filluar iniciativat e të dy qeverive tona, me qëllim të hapjes së horizonteve të bashkëpunimit të dy vendeve. Janë arritur shumë marrëveshje por, rrugës, për shkak të pengesave burokratike dhe neglizhencës, jo gjithherë ato marrëveshje janë zbatuar. Pas shumë takimeve, duke parë se ka probleme në zbatimin e marrëveshjeve, duke parë vërejtjet dhe ankesat e qytetarëve dhe t` grupeve të interesit, atëherë në mbledhjen e fundit është propozuar grupi i koordinimit të zbatimit të këtyre marrëveshje. Prej 80 marrëveshjeve, një pjesë e tyre nuk janë zbatuar. Tani jemi duke i monitoruar këto marrëveshje dhe të shohim pse nuk po zbatohen dhe të fillojë zbatimi i tyre", ka theksuar Limaj.

Për të pasur një bashkëpunim më të lehtë ekonomik ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë ishin investuar miliarda euro në infrastrukturë rrugore. Megjithatë, vlerësohet se këto dy shtete gjatë shkëmbimeve tregtare vazhdojnë të hasin në vështirësi dhe konsiderohet se nuk kanë arritur të kenë marrëdhënie tregtare në nivel të kënaqshëm.

Të dhënat zyrtare tregojnë se Shqipëria eksporton në Kosovë mallra në vlerë rreth 200 milionë eurosh në vit, kurse vlera e produkteve që Kosova eksporton në Shqipëri është rreth 60 milionë euro.

Për një vit u lindën 65 foshnja nga nënat nën moshën 18-vjeçare

Prishtinë, 3 mars - Lindjet e foshnjave nga nënat nën moshën 18-vjeçare po bëhen dukuri shqetësuese në Kosovë. Vetëm gjatë vitit 2018 në Klinikën Gjinekologjike në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës kanë lindur 65 foshnja nga nënat e moshës jomadhore. Gjatë vitit 2017 ishin regjistruar 35 lindje nga nënat nën moshën 18-vjeçare. Kjo dukuri ka shënuar rritje vit pas viti, ngaqë në vitin 2016 ishin shënuar 22 raste të lindjeve të tilla.

Drejtoresha në Klinikën Gjinekologjike, Myrvete Paçarada, ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se, ndonëse është rrezik për jetën e nënave që të lindin fëmijë në moshë jomadhore, nuk ka ndodhur asnjë rast i vdekjes së tyre. "Si profesionistë shëndetësorë jemi kundër asaj që nënat të lindin nën moshën 18-vjeçare për shkak të rreziqeve që i kanosen nënës së re. Është mirë që nëpër shkolla, institucione, të apelohet për planifikim familjar, të përdorin kontraceptivë, në mënyrë që familja të planifikohet mbi moshën 18-vjeçare", ka thënë Paçarada.

Në shkollat e Kosovës nuk ka lëndë për edukatën seksuale. Profesionistë të kësaj fushe e shohin si të nevojshme futjen e kësaj lënde brenda kurrikulës.

Fehmi Krasniqi, koordinator për shkenca natyrore në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, njëherësh hartues i rezultateve për edukatë seksuale si ekspert në UNFPA, thotë se futja e lëndës Edukatë seksuale në shkolla është e domosdoshme. Sipas tij, për këtë lëndë janë duke u trajnuar mësimdhënësit.

Lëvizja FOL ka publikuar të dhënat e monitorimit të zbatimit të planit vjetor të punës së Qeverisë së Kosovës për vitin 2018

FOL-i: Qeveria ka realizuar 64 për qind të planit të punës për vitin 2018

Qeveria e Republikës së Kosovës gjatë vitit 2018 ka arritur të realizojë 64 për qind të planit vjetor të punës, përkatësisht nga 921 aktivitete të parapara, ka përfunduar 594 prej tyre. Këto janë të dhënat e monitorimit të zbatimit të planit vjetor të punës së Qeverisë së Kosovës për vitin 2018 të realizuar nga Lëvizja FOL. Sipas këtij monitorimi, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale është e vetmja që ka realizuar 100 për qind planin vjetor të punës, kurse Ministria e Infrastrukturës është renditur e fundit me vetëm 35 për qind të realizimit të planit vjetor

EPOKA E RE — Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 3 MARS - Lëvizja FOL të dielën ka publikuar të dhënat statistikore të monitorimit të zbatimit të planit vjetor të punës së Qeverisë së Kosovës për vitin 2018. Me këtë rast, Mexhide Demolli-Nimani ka thënë se është në interes të qytetarëve që të analizohet puna dhe performanca e Qeverisë. Në një konferencë për medie ajo ka treguar se FOL-i ka bërë monitorimin e planit vjetor të punës së 21 ministrive dhe Zyrës së Kryeministrit. Demolli-Nimani ka bërë me dije se të dhënat e këtij monitorimi tregojnë se ka pasur nivel të ulët të realizimit të planit të paraparë. "Nga ky monitorim del se nga 921 aktivitete të parapara në planin vjetor të punës së Qeverisë për vitin 2018, vetëm 594 apo, shprehur në përqindje, 64 për qind janë realizuar. Ndërkaq 237 aktivitete apo 26 për qind kanë mbetur të parealizuara në afatin e përcaktuar kohor", ka deklaruar ajo, duke shtuar se Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale ka arritur t'i realizojë të gjitha aktivitetet e parapara. "Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale nga 18 aktivitete të parapara në planin vjetor të punës së Qeverisë për vitin 2018, ka realizuar të gjitha aktivitetet. Shprehur në përqindje, kjo është ministria e vetme e cila ka realizuar 100 për qind të aktivitetet e parapara", ka theksuar Demolli-Nimani.

Ndërsa Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal në planin e punës kishte paraparë të realizojë 50 aktivitete, me ç'rast ka arritur t'i përfundojë 45 prej tyre apo 92 për qind. Edhe Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë ka arritur të realizojë 92 për qind të planit të punës, përkatësisht prej 13 aktivitete ka realizuar 12 sosh. Kurse Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) prej 21 aktiviteteve të parapara ka realizuar 19 prej tyre apo 90 për qind të planit.

Edhe Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit ka arritur t'i realizojë 90 për qind të planifikimeve pasi, prej 61 aktiviteteve, 55 prej tyre i ka përfunduar. Ndërsa Ministria e Financave për vitin 2018 kishte paraparë 45 aktivitete, nga të cilat i ka realizuar 39 apo 87 për qind.

Sipas statistikave të monitorimit të FOL-it, Ministria e Administratës Publike prej 82 aktiviteteve të planifikuara ka arritur t'i realizojë 67 sosh apo 82 për qind.

Edhe Ministria e Zhvillimit Rajonal, prej 25 aktiviteteve të parapara për vitin 2018, ka realizuar 20 aktivitete apo 80 për qind të planit. Ndërkaq Ministria e Diasporës dhe Investimeve Strategjike ka përfunduar 34 aktivitete nga 45 sa kishte paraparë në planin vjetor të punës apo 76 për qind. Edhe Ministria për Komunitete dhe Kthim ka arritur ta realizojë 76 për qind të planit të punës, përkatësisht ka përfunduar 13 aktivitete nga 17 sosh. Kurse Ministria e Punëve të Brendshme, që kishte planifikuar 95 aktivitete, ka arritur t'i përfundojë 69 prej tyre apo 73 për qind.

Për dallim nga shumica e ministrive, Zyra e Kryeministrit, e cila kishte paraparë t'i realizojë 117 aktivitete në kuadër të planit vjetor të punës, ka realizuar vetëm 75 sosh apo 64 për qind.

Ndërsa Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ka arritur ta realizojë 62 për qind të planit vjetor të punës pasi, prej 39 aktiviteteve të planifikuara, ka përfunduar 15 prej tyre. Kurse Ministria e Zhvillimit Ekonomik, prej 20 aktiviteteve sa kishte planifikuar të realizojë për vitin 2018, ka arritur t'i realizojë 12 sosh apo 60 për qind. Ndërkaq Ministria e Drejtësisë, prej 64 aktiviteteve të parapara në planin vjetor të punës, ka arritur t'i realizojë 34 prej tyre apo 53 për qind.

Edhe Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural ka realizuar 53 për qind të planit vjetor të punës, përkatësisht nga 59 aktivitete të planifikuara, ka përfunduar 31 sosh.

Ministria e Shëndetësisë, në kuadër të planit të punës, ka realizuar 19 aktivitete nga 37 sa ishin të parapara apo 51 për qind. Ndërkaq Ministria e Infrastrukturës, prej 23 aktiviteteve të parapara në planin e punës, ka realizuar vetëm 8 nga to apo 35 për qind. Ndërsa për Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Ministrinë e Integrimit Evropian nuk dihet se sa është realizuar plani i tyre njëvjeçar pasi që nuk i janë përgjigjur Lëvizjes FOL.

Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë kishte paraparë 14 aktivitete, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë 30 aktivitete, Ministria e Punëve të Jashtme 15 aktivitete si dhe Ministria e Integrimit Evropian kishte paraparë 31 aktivitete. Sipas Lëvizjes FOL, disa nga ministritë kanë dërguar sqarime shtesë për të gjitha aktivitetet për të cilat nuk kanë arritur t'i përfundojnë sipas afatit të paraparë në planin vjetor të punës.

Në Leshan të Pejës zbulohet pllaka në shtëpinë e cila u bë shtab lokal i UÇK-së

PEJË, 3 MARS - Në Leshan të Pejës është zbuluar pllaka në shtëpinë e cila kishte shërbyer si shtab lokal i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Shtëpia e invalidit të luftës Ukë Krasniqi (tanimë i ndjerë) të dielën kishte mbledhur dhjetëra bashkëluftëtarë, në mesin e të cilëve edhe Azem Veseli, ish-komandant i Brigadës 133 "Adrian Krasniqi".

Kryetari i OVL të UÇK-së Pejë, Gazmend Syla, ka theksuar se vendosja e pllakave në shtëpitë që shërbyen si shtabe është nder për familjen dhe bashkëluftëtarët, por edhe rikujtim i historisë së lavdishme të luftës çlirimtare. Ai ka shpërndarë mirënjohje për themelimin e shtabit lokal në shenjë respekti për nismëtarët e rezistencës së armatosur në këtë fshat.

Pllaka u zbulua nga Azem Veseli, Qerim Berisha-"Mixha", Bajram Shkodrani dhe Jeton Krasniqi.

PËR DY MUAJ DOGANA MBLEDH 6.6 PËR QIND MË SHUMË TË HYRA

PRISHTINE 3 MARS (ER) - Në dy muajt e parë të këtij viti Dogana e Kosovës ka inkasuar të hyra në rritje prej 6.6 përqindësh. "Gjatë periudhës dymujore të këtij viti (janar - shkurt 2019) të hyrat e përgjithshme të inkasuara nga Dogana e Kosovës në total arritën vlerën rreth 141.2 milionë euro që, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2018, paraqet rritje prej 8.7 milionë ose, shprehur në përqindje, 6.6 për qind më shumë", është bërë me dije në njoftimin e Doganës së Kosovës.

Bëhet me dije se ndikim në të hyrat e grumbulluara nga Dogana gjatë kësaj periudhe ka pasur edhe MSA-ja, pakoja fiskale që iu referohet lirimeve nga taksat në import për prodhuesit. "Ndikimi në të hyra nga MSA-ja përgjatë kësaj periudhe është rreth 7.5 milionë euro nga 5.2 milionë euro që ishte në dymujorin e vitit të kaluar, kurse ndikimi në të hyra i pakos fiskale për prodhues rreth 10.8 milionë euro nga 7.6 milionë euro që ishte vitin e kaluar. Gjithashtu, një zhvillim tjetër me rëndësi është edhe rritja e numrit të kompanive prodhuese që përdorin procedurat e autorizuara sipas pakos fiskale. Vitin e kaluar kishim 252 kompani të autorizuara, kurse tani ky numër ka arritur në 353 kompani të autorizuara. Përkundër te gjitha këtyre ndikimeve në të hyrat e grumbulluara nga Dogana, ne kemi vazhduar me performancë të lartë inkasimin e të hyrave për periudhën raportuese janar - shkurt 2019", është theksuar në njoftimin e Doganës.



REÇICA I LUMTUR QË MPMS-ja KA REALIZUAR 100 PËR QIND TË AKTIVITETEVE TË PARAPARA PËR VITIN 2018

Prishtinë, 3 mars (ER) - Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skender Reçica, ka thënë se është shumë i lumtur që edhe raporti i Lëvizjes FOL ka evidentuar se ministria që drejton ka realizuar 100 për qind të aktiviteteve të parapara për vitin 2018. "Vitin 2018 në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale e patëm shpallur vit të reformave në të gjitha fushat që mbulojmë. Përkushtimi dhe menaxhimi p`r realizimin e aktiviteteve të parapara në plan ka qenë maksimal. Jam shumë i lumtur që edhe raporti i Lëvizjes FOL ka evidentuar se MPMS ka realizuar 100 për qind të aktiviteteve të parapara për vitin 2018", ka shkruar Reçica në llogarinë e vet në "Facebook". Ai ka shtuar se ndihet i nderuar që udhëheq një dikaster që në fokus ka mirëqenien e përgjithshme të qytetarëve. "Nuk do të ndalem së angazhuari për avancim të mirëqenies së qytetarëve dhe për përmbushjen e obligimeve ligjore dhe morale ndaj tyre", ka thënë Reçica.

LIGJVËNËSIT SABOTOJNË QËLLIMISHT PROJEKTLIGJET EKONOMIKE

Një mori projektligjesh të çështjeve ekonomike vazhdojnë të sabotohen në seancat plenare të Kuvendit duke mos hyrë në votim. Përfaqësues të organizatës "Konsumatori" dhe të Odës së Afarizmit kanë thënë për gazetën "Epoka e re" se neglizhimi i projektligjeve dhe çështjeve ekonomike nga ana e ligjvënësve është i qëllimshëm. Kurse Artan Murati nga KDI-ja ka pohuar se duhet të merren masa ndëshkuese për deputetët që nuk marrin pjesë në seanca

EPOKA E RE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 3 MARS - Ndonëse në seancën e 28 shkurtit ishte paraparë të shqyrtoheshin 12 projektligje, vetëm dy prej tyre arritën ta marrin dritën jeshile. Sa iu përket projektligjeve të fushës së ekonomisë në rend të ditës ishin: Votimi në lexim të dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Automjete, shqyrtimi i dytë i Projektligjit për tatimin në të ardhurat personale, shqyrtimi i dytë i Projektligjit për tatimin në të ardhurat e korporatave, Projektligjit për miniera dhe minerale, votimi në lexim të dytë i Projektligjit për miniera dhe minerale, si dhe votimi i raportit të Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare. Këto projektligje nuk arritën t'i nënshtrohen votimit në mungesë të kuorumit.

Lidhur me këtë kryetari i Odës së Afarizmit të Kosovës, Skënder Krasniqi, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se ligjvënësit, edhe përkundër që e kanë gojën me agjendën ekonomike, po tregojnë të kundërtën. Sipas tij, shteti është duke i ngarkuar taksapaguesit e sektorit privat për të përmbushur hendekun buxhetor, njëkohësisht është duke e çuar vendin në katastrofë ekonomike. "Pavarësisht prej deklaratave të të gjitha institucioneve qeveritare, duke filluar nga presidenti, se agjenda ekonomike do të jetë prioritet, po rezulton e kundërta. Asnjë qeveri deri më tani nuk e kishte prioritet kryesor zhvillimin e vendit. Vetë fakti që nga 1.2 milion qytetarë janë në moshë pune, 350 000 apo vetëm 29 për qind e qytetarëve janë të punësuar dhe nga 600 000 femra në moshë pune, janë të punësuara vetëm 12 për qind apo 88 për qind janë të papuna. Kjo tregon realitetin e rëndë në të cilin jemi", ka thënë Krasniqi, duke shtuar se me vendimin për rritje të pagave në sektorin publik është dëmtuar rëndë mirëqenia e taksapaguesve te sektori privat që, sipas tij, është vepruar për interesa klanore dhe elektorale. "Me këto veprime janë duke e dërguar shtetin në katastrofë ekonomike. Shteti, duke mos pasur zhvillim, ka vendosur në kontinuitet taksa të ndryshme, të cilat në shikim nuk duken shumë, por që e rëndojnë buxhetin e qytetarëve çdo ditë e më shumë. Kur jemi te Projektligji për automjetet, nëse një sigurim është i paguar ai duhet të bartet, pasi pagesa për atë kohë është bërë dhe s'ka nevojë të bëhet dy herë. Kjo është shkelje e Kushtetutës dhe ligjeve që të paguhet dy apo tri herë për të njëjtën punë. Kemi edhe taksën e ujitë që është e dyfishtë. Është e palogjikshme që Kosova të jetë i vetmi vend në Evropë që e kushtëzon vjetërsinë, ndërkohë që jemi vendi më i varfër në Evropë. Do të duhej që standardet e makinës të shikohen kur makina del në qarkullim, si dhe çështjen e filtrimit të gazrave dhe jo vjetërsinë", u shpreh ai.

Safete Hadergjonaj, zëvendëskryetare e parë në Komisionin për Buxhet dhe Financa, si dhe deputete nga radhët e PDK-së, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se, edhe pse bëhet punë e jashtëzakonshme në këtë komision, mospjesëmarrja pjesë e deputetëve në seanca po zvarrit agjendën ekonomike. "Mund të themi se vëmendje u kushtohet projektligjeve për çështje ekonomike, sepse është bërë një punë e jashtëzakonshme në Komisionin për Buxhet dhe Financa në lidhje me reformën që ka marrë Qeveria, respektivisht Ministria e Financave sa i përket politikës fiskale, por e keqja është se nuk po mobilizohemi sa duhet në seanca plenare për t'i siguruar numrat", ka thënë Hadergjonaj, duke shtuar se edhe opozita duhet të jetë korrekte dhe të marrë pjesë në votim kur është në pyetje interesi i qytetarëve. "Mendoj se pozitë dhe opozitë duhet të jenë korrekte në këtë drejtim, duke e ditur se është interes i vendit dhe i qytetarëve që të votohen këto ligje. Në ditët që mbahen seancat është obligim i grupeve parlamentare që të mobilizohen për pjesëmarrje të deputetëve në seanca", ka deklaruar Hadergjonaj.

Ajo ka thënë se janë pro Ligjit për Automjete pasi është kërkesë e qytetarëve.

Artan Murati nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka theksuar për gazetën "Epoka e re" se deputetët e Kuvendit të Kosovës janë duke e shpërfillur punën e tyre. "Jo vetëm ligjet që kanë karakter ekonomik, por të gjitha ligjet e tjera janë duke pasur problem që të miratohen, e sidomos të monitorohen në zbatim, pasi Kuvendi s'ka munduar ta kryejë punën karshi agjendës legjislative. Në qeverisjen e kaluar Kuvendi ka miratuar 75 ligje, që është numër i lartë nëse krahasohet me vitet parapake, por prapëseprapë s'kishte debat të mirëfilltë dhe kishte procedura të zvarritura", u shpreh ai.

Murati ka bërë me dije se janë edhe 51 projektligje që presin të hyjnë në votim. "Ka një numër të projektligjeve që janë në shqyrtim e sipër nëpër komisione. Për momentin janë 51 projektligje që janë në procedurë, por edhe kur po hyjnë në procedurë për seancë plenare projektligjet shpesh po mbeten të papërfunduara dhe po zvarriten deri në miratimin e tyre për shkak të mosefikasitetit të punës së deputetëve dhe pamundësisë për vendimmarrje për shkak të mungesës së kuorumit që është një ndër problemet kryesore të kësaj legjislature", u shpreh ai.

Murati ka thënë se duhet të zbatohen masa disiplinuese ndaj deputetëve që nuk marrin pjesë në seanca. "Së pari duhet për t'u garantuar shumica parlamentare, pasi s'ka numra të mjaftueshëm për t'i kaluar ligjet. Edhe kur votohen projektligjet me subjektet opozitare shpeshherë ka kushtëzime, pra shumica parlamentare duhet të ndërmarrë veprime. Përveç bojkotit, shpeshherë të opozitës, që është bojkot i ligjshëm, sepse opozitën nuk mund ta detyrosh ta bëjë kuorumin, prapë nuk ka vota të mjaftueshme për të kaluar një numër të konsiderueshëm projektligjesh. Me rregulloren e re ishte dashur që kodi i etikës t'i parashohë masat ndëshkuese, përveç këtyre aktuale që janë", ka thënë Murati.

Ndërkaq sa i përket agjendës ekonomike, sipas tij, janë në pritje nga Qeveria që të shkojnë në Kuvend: Plotësim dryshimi i Ligjit për Zonat Ekonomike, Projektligji për Turizëm, Projektligji për Ndërmarrjet Publike, Projektligji për Masat për uljen e kostos së shtrirjes së rrjeteve të komunikimeve elektronike dhe Projektligji për Identifikimin Elektronik dhe shërbimet e besuara lidhur me transaksionet elektronike. "Këto projektligje pritet të shkojnë në Kuvend, ashtu siç janë paraparë në agjendën legjislative", ka thënë Murati.

Kryetari i organizatës "Konsumatori", Selatin Kaçaniku, ka thënë se neglizhimi i projektligjeve dhe çështjeve ekonomike nga ana e ligjvënësve është i qëllimshëm. "Për qytetarët taksapagues situata aktuale është shumë e dhimbshme, pasi padrejtësitë më të mëdha po bëhen nga partitë politike. Padrejtësitë e tyre ndaj qytetarëve taksapagues dëshmohen me sjelljet e tyre në Kuvend, Qeveri dhe në ministri. S'e di qysh kanë fytyrë të kërkojnë vota dhe taksa prej neve. Konsumatori taksapagues është gjeneruesi kryesor i shtetit. Partitë qëllimisht i sabotojnë ato ligje qe u konvenojnë atyre, por jo ato që i konvenojnë qytetarit taksapagues", u shpreh Kaçaniku për gazetën "Epoka e re".

IMPRESIONE NGA DITA E PARË E SAMITIT TË DIASPORËS

Prof. Lisen BASHKURTI

Po mbahet Samiti i dytë i Diasporës Shqiptare. Është një ngjarje me shumë rëndësi që buron nga vlera e jashtëzakonshme që ka diaspora shqiptare për kombin, popullin dhe shtetin shqiptar. Përgjithësisht është për t'u përshëndetur një iniciativë e tillë. Ndonëse nuk kanë munguar edhe kritikat e shumta lidhur me formatin, me kohën dhe me shpenzimet publike të bëra për mbajtjen e tij.

Konfuzion rreth definicionit 'diasporë'

Pa u bërë as pjesë e tifozëve për dhe e kritikëve kundër, mua ma tërheqin vëmendjen disa aspekte që lidhen me keqkuptimin ose më saktë me keqpërdorimin e përcaktimit diasporë në Samit. Definicioni ose përcaktimi shkencor i termit 'diasporë' është qartësuar nga shkencat shoqërore shumë kohë më parë. 'Diasporë do të thotë një grup i madh njerëzish me lidhje të ngjashme trashëgimie ose atdheu, i cili është larguar nga vendi i tij për t'u vendosur anembanë botës'. Keqkuptimi ose abuzimi me termin diasporë më tërhoqi vëmendjen nga dy aspekte kryesore të Samitit: nga pjesëmarrësit dhe nga fjalimet kryesore që u mbajtën.

Lidhur me pjesëmarrësit mendoj se ishte bërë mirë që ishin ftuar shqiptarë të shumtë nga Kosova, Maqedonia, Mali i Zi dhe Lugina e Preshevës. Por, referuar definicionit shkencor të termit diasporë, asnjëri nga këto grupe shqiptare të ardhur nga Ballkani Perëndimor nuk bëjnë pjesë në kategorinë 'diasporë', sa kohë ato nuk janë të larguar nga trojet e tyre diku gjetkë nëpër vende të huaja në botë.

Shqiptarët në Kosovë, Maqedoni, Mal të Zi dhe në Luginën e Preshevës janë shqiptarë etnikë në origjinën e tyre dhe autoktonë në trojet e veta. Me fjalë të tjera janë grupe njerëzish me të njëjtën trashëgimi origjine dhe vazhdues në të njëjtat troje të tyre etnike. Konsiderimi i shqiptarëve të Kosovës, Maqedonisë, Malit të Zi dhe Luginës së Preshevës, nën definicionin 'diasporë', është shkencërisht e pasaktë dhe politikisht e gabuar.

Fjalimet, agjenda politike, jo agjenda diaspore

Lidhur me fjalimet kryesore që u mbajtën nga kryeministri i Shqipërisë, Rama dhe presidenti i Kosovës, Thaçi, mund të thuhet se të dy ishin të një goje, njëkohësisht në një dizakord të përbashkët. Të dy luajtën në një akord të përbashkët politik dhe të dy dolën jashtë akordit të përbashkët 'diasporë'. Akordi i përbashkët politik u duk në ngritjet e toneve nacionaliste nga të dy. Kryeministri Rama hodhi 'tezën retorike bajate' të bashkimit shqiptar. Presidenti Thaçi u betua dhe përbetua se 'copëtimi i kufijve të Kosovës mund të ndodhte vetëm nëse kalohej mbi trupin e tij'.

Dukej nga kushdo që këto ide dhe tone nacionaliste të panatyrshme, të panevojshme dhe të padobishme, ishin të sinkronizuara dhe u bënë për qëllime konjukturale: Rama për ta larguar vëmendjen nga kriza politike, ekonomike dhe sociale e brendshme dhe nga akuzat për përzierje në negociatat për copëtimin e Kosovës; Thaçi për ta rikuperuar imazhin e vet të rrënuar, të shkaktuar nga tezat e tij për 'korrigjim', 'ndryshim', 'shkëmbim', apo 'korrigjim të lehtë' të kufijve midis Kosovës dhe Serbisë. Të dy liderët abuzuan mjedisin e diasporës për agjendat dhe përgjegjësitë e veta politike personale.

Ndërsa dizakordi i përbashkët i të dy folësve lidhej me anashkalimin e çështjeve themelore të diasporës shqiptare në botë dhe marrëdhënieve të saj me shtetet amë. Këto çështje kanë të bëjnë me ngushtimin e distancave midis diasporave dhe shteteve amë, me vendosjen e urave përfaqësuese dhe participuese të diasporave në jetën e brendshme të shteteve tona, me rritjen e kontributeve të shteteve amë për nevojat e diasporës, me veprime të sinkronizuara strategjike shtet-diasporë dhe me forcimin e identitetit kombëtar dhe ngritjen e reputacionit të kombit shqiptar në botë. Të dy liderët i anashkaluan nga fjalimet e tyre këto çështje specifike të diasporës. Zhurmat nacionaliste lanë në hije qëllimet kryesore për të cilat duhet të shërbejnë samite të tilla për diasporën.

Të mos harrojmë se ky është Samiti i Dytë i Diasporës. Kjo presupozon, para se gjithash, të bëhet një bilanc mbi punën e bërë, me arritjet, sukseset dhe dështimet. E më tutje të përpilohen strategji, prioritete, plane veprimi, masa konkrete, institucione dhe burime njerëzore e financiare në zbatim të tyre. Këto janë impresionet e ditës së parë të Samitit. Le të shpresojmë se dita e dytë do të jetë më frytdhënëse.

Në shkollat e Mitrovicës fillon zëvendësimi i orëve të humbura gjatë grevës së janarit

MITROVICË, 3 MARS (ER) - Në shumë shkolla të Komunës së Mitrovicës, në harmoni me vendimin që ka marrë Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë (MAShT), ka filluar kompensimi i ditëve të humbura si pasojë e grevës së personelit arsimor.

Drejtori i Arsimit në këtë komunë, Iset Beka, ka thënë se në shumicën e shkollave e kanë respektuar vendimin e MAShT-it për zëvendësimin e orëve të humbura. "Shumë shkolla të komunës sonë sot janë duke zbatuar në plotësi vendimin e MAShT-it që të kompensohen orët e humbura gjatë periudhës së grevës së arsimtarëve. Këtë e kemi parë vetë në vizitën që kemi bërë me stafin e drejtorisë në disa shkolla tona" ka thënë Beka. Me këtë rast, drejtori Beka ka falënderuar personelin arsimor në këto shkolla për respektimin e vendimit dhe gatishmërinë që ta përmbushin planprogramin e punës në procesin arsimor.

Ndërsa zyrtarët komunalë nga Drejtoria Komunale e Arsimit (DKA) kanë theksuar se vijueshmëria e nxënësve është sikurse në secilën ditë që dëshmon seriozitetin e angazhimit edhe të shkollave dhe të prindërve dhe vetë nxënësve për t'i kompensuar ditët e humbura të shkollës.

Vehbi Nazifi zgjedhet kryetar i Degës së PDK-së në Dragash

DRAGASH, 3 MARS (ER) - Partia Demokratike e Kosovës (PDK) ka përmbyllur të dielën zgjedhjet e brendshme në Degën e Dragashit, ku me shumicë të votave të delegatëve, kryetar i kësaj dege është zgjedhur Vehbi Nazifi.

Kryetari i ri i PDK-së në Dragash ka falënderuar delegatët për besimin e dhënë dhe është zotuar se do të punojë për vazhdimin e sukseseve të PDK-së në këtë komunë. Kuvendi zgjedhor ka zgjedhur edhe Këshillin Drejtues të degës prej 55 anëtareve si dhe 13 delegatë për Konventën Qendrore.

Në emër të kryetarit të PDK-së, Kadri Veseli, delegatët e pranishëm në këtë kuvend zgjedhor i ka përshëndetur ministri për Kulturë, Rini e Sport, Kujtim Gashi. Ai ka deklaruar se platforma politike "Dekada e re", e prezantuar nga lideri i PDK-së, Kadri Veseli, ka për qëllim zhvillimin e qëndrueshëm të të gjitha komunave pa dallim nëpërmjet reformave dhe ofrimit të hapësirës për kuadro të reja të cilat do të jenë në shërbim të ndërmarrësisë dhe ideve inovatore të qytetarëve.

Ndërsa për sukseset e Degës së PDK-së në Komunën e Dragashit kanë folur kryetari i deritashëm i degës, Salim Januzi, si dhe kryetari i komunës, Shaban Shabani.

Kryetari i Komunës së Dragashit, Shaban Shabani, ka thënë se vizioni i PDK-së po mbështetet nga të gjithë qytetarët dhe se ky vizion do të vazhdojë t'i mbështesë kuadrot e reja që i janë bashkuar PDK-së gjatë procesit zgjedhor për jetësimin e platformës "Dekada e Re".

FOSHNJËRIA E POLITIKËS SONË

Shkruan: Prof. Ass. Dr. Sabri KIÇMARI

Në një ligjëratë të mbajtur para rreth një viti në Bibliotekën e Kryeqytetit e pata shpjeguar fenomenin e shprishjes së politikës. Brenda një viti gjendja ka shkuar duke u keqësuar edhe më shumë. Nga shprishja e politikës gjendja ka lëvizur në drejtim edhe më negativ: në gjendjen e foshnjërisë dhe irracionalizmit politik. Nuk mund të kualifikohet ndryshe gjendja, kur tre krerët më të lartë shtetërorë për dialogun me Serbinë dhe taksën 100 për qind kanë qëndrime të ndryshme. Këtij irracionaliteti i shtohet edhe fakti se edhe të tri partitë opozitare, për këto dy tema, kanë dallime të mëdha. Pra, rrjedhimisht kemi gjashtë qëndrime të ndryshme për dy tema të rëndësishme, që mund të kualifikohen si tema të interesit nacional.

Si mund të shpjegohet një irracionalitet i tillë?

Përgjigja në lidhje me këtë është fare e thjeshtë. Liderët politikë i kanë vendosur interesat pushtetore e partiake para atyre nacionale e shtetërore. Kjo gjendje, nuk mund të kualifikohet ndryshe, pos si foshnjëri politike. Interesat e Republikës së Kosovës në raport me Serbinë nuk mund të jenë as gjashtë sosh, as tri dhe as dy interesa të ndryshme. Ka vetëm një interes: ruajtja e integritetit territorial dhe raporte korrekte fqinjësore, të bazuara në parimin e reciprocitetit. Mbi këtë parim, përfaqësuesit tonë politikë do të duhej urgjentisht të ndërtojnë unitetin nacional. Të krijosh unitet, do të thotë të respektosh edhe mendimin e tjetrit, të peshosh interesat nacionale bashkë me tjetrin, duke lënë interesin e ngushtë partiak dhe pushtetor. Krerët institucional të Republikës së Kosovës kanë bërë një numër gabimesh vitin e fundit në lidhje me qëndrimin e Republikës së Kosovës ndaj Serbisë. Gabimi i parë është hapja e debatit në lidhje me kufirin dhe territorin. Në teorinë e marrëdhënieve ndërkombëtare janë të njohura katër atribute të shtetësisë: popullsia, territori, qeveria dhe hyrja në marrëdhënie bilaterale me shtetet e tjera. Vënia në diskutim e secilit nga këto atribute është goditje e sovranitetit shtetëror. Gabimi i dytë është propozimi për një Konferencë Ndërkombëtare. Kjo kërkesë i shndërron raportet në mes të Kosovës nga konteste teknike e politike në mes të dy vendeve fqinje, të cilat duhet zgjidhur, në një kontekst ndërkombëtar, të një çështjeje të pazgjidhur, që tashmë de facto është e zgjidhur. Edhe ky gabim ka ardhur si rezultat i mospeshimit me kujdes të taktikës dhe strategjisë së veprimit të krerëve institucional dhe udhëheqësve politikë. Gabimi i tretë janë thirrjet e shpeshta "për rrumbullaksimin e shtetësisë". Me këtë thirrje, dëshmohet se disa përfaqësues të shtetit tonë e konceptojnë shtetësinë e Kosovës si në vitet 1990, kur Kosova de facto nuk ishte shtet, pra si një çështje të parrumbullaksuar, të papërmbyllur. Kjo flet për vetëdijen e tyre të paformësuar shtetërore. Duke u munduar ta argumentojnë këtë gjë sot me mospranimin e Kosovës në OKB, ata harrojnë se rasti i Kosovës është vetëm një, në mesin e shumë rasteve, kur, për arsye të ndryshme politike, një shtet nuk kandidon ose bllokohet të pranohet në OKB. Rasti i Zvicrës (deri në vitin 2002), i Republikës Popullore të Kinës (1971), Gjermanisë Federale (1973) janë vetëm disa nga rastet e shumta, kur shtetet kanë pritur me decenie të pranohen në OKB, por asnjëherë nuk e kanë konsideruar veten shtet me shtetësi të parrumbullakuar. Rrjedhim i mosunitetit në qëndrime është edhe krijimi i dy grupeve negociuese me Serbinë. Edhe ekipi negociator me dy bashkëdrejtues, i krijuar nga Qeveria e Republikës dhe i pranuar nga më pak se gjysma e deputetëve, nuk e përfaqëson vullnetin e shumicës së qytetarëve të Kosovës. Deficiti më i madh në legjitimitetin e delegacionit është fakti se në të nuk marrin pjesë dy partitë më të mëdha opozitare, që, në fakt, janë edhe dy nga tri partitë më të mëdha në vend. Fakti se ekipi udhëhiqet nga dy liderë partish, me numër të vogël deputetësh, e vë në pozitë edhe më jolegjitime këtë ekip. Edhe opozita nuk është në gjendje më të mirë. Përderisa njëra nga partitë politike ka vendosur të luaj rolin mbështetës për Qeverinë e pakicës, duke e kushtëzuar mbështetjen me kërkesa të caktuara politike, dy partitë e tjera opozitare ftojnë për zgjedhje të parakohshme. Përderisa njëra nga partitë opozitare fton për tërheqje të taksës 100 për qind, dy partitë e tjerat ftojnë për mbajtjen e saj.

Ku janë qytetarët në këtë mes?

Qytetarët e Kosovës i vëzhgojnë me dëshirim të gjitha këto zhvillime. Dëshpërimi është i madh për shkak të moslibералizimit të vizave, për shkak të tërheqjes së njohjeve, për shkak të foshnjërisë politike të aktorëve tanë politikë. Përfaqësuesit e Qeverisë janë ngutur në deklarimet e tyre, duke shtuar pritjet në lidhje me liberalizimin e vizave. Shihet se ata nuk e patën studiuar me kujdes procesin e vendimmarrjes brenda BE-së. Ministrat e brendshëm të vendeve të BE paraqesin dorën e ashpër vendimmarrëse në lidhje me liberalizimin. Është dashur të parashihet me kohë, se një vendim i tillë nuk varet vetëm nga Komisioni dhe vetëm nga Parlamenti Evropian. Nuk është dashur të yshten pritjet e tilla!

Cila është dalja nga kjo situatë absurde?

Dalja nga situatat e tilla kanë vetëm një derë: zgjedhjet e parakohshme. Duke pasur parasysh se mosbesimi brenda koalicionit qeverisës është enorm, se nuk ka fare mbështetje për idenë e presidentit të Republikës për korrigjim të kufirit, se ka një zhgënjim të madh të qytetarëve me këtë lloj mungese racionaliteti dhe foshnjërie politike, duke e pasur parasysh ineficiencën e plotë në politikën e jashtme, zgjidhja e vetme racionale janë zgjedhjet e reja të parakohshme. Një ristrukturim institucional, me legjitimitet të ri demokratik, do të ishte një antibiotik i fortë për këtë atmosferë të zymtë politike dhe një rikthim drejt racionalitetit të politikës sonë. Pas zgjedhjeve të parakohshme do të mund të krijohej një ekip negociuese me mbështetje edhe të opozitës, i cili do të mund të balanconte me kujdes interesat dhe të ndërtonte taktikën dhe strategjinë e qëndrimit shtetëror në raport me Serbinë.

Daut Haradinaj zgjedhet kryetar i Degës së AAK-së në Deçan

Deçan, 3 mars (ER) - Dega e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) në Deçan ka mbajtur Kuvendin e Tetë Zgjedhor, në të cilin ka rizgjedhur deputetin Daut Haradinaj kryetar të kësaj dege. Pas rizgjedhjes në këtë detyrë, Haradinaj ka theksuar se ndihet krenar për punën që e kanë bërë në këto vite dhe se suksesi është i përbashkët i të gjithëve. "Unë kam pasur nderin të punoj për këta tre vjet e gjysmë në degën e Aleancës. Është e vërtetë se për shkak të suksesit të përbashkët sot udhëheqim Qeverinë. Bashkim Ramosaj udhëheq komunën. Po ashtu, të gjithë kandidatët për deputetë nga Deçani janë zgjedhur deputetë", ka deklaruar Daut Haradinaj.

Vazhdon procesi i inspektimit final të objekteve në Prishtinë

Prishtinë, 3 mars (ER) - Ekipi përgjegjës ka inspektuar edhe tri objekte të tjera në Prishtinë, pronarët e të cilave kishin aplikuar për inspektim final dhe certifikatë të përdorimit (ish-pranimi teknik). "Meqë në vazhdimësi ka kërkesa nga qytetarët për t'u informuar për këtë proces, gjatë javës së ardhshme do t'i publikojmë listat e atyre që kanë aplikuar deri tash (për objektet kolektive), me shpjegime për fazën në të cilën gjenden. Ka raste që kanë përfunduar me sukses, por ka edhe refuzime", është thënë në komunikatën e Komunës së Prishtinës.

ShBA-ja dhe Koreja e Jugut i ndërpresin stërvitjet ushtarake

Uashington, 3 mars - Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Koreja e Jugut kanë vendosur që të mos kryejnë më manovrat e përvitshme ushtarake, me qëllim që t'i ndihmojnë përpjekjet diplomatike me Korenë e Veriut.

Pentagoni njoftoi se shefat e mbrojtjes së ShBA-së dhe Koresë së Jugut kanë vendosur që t'u japin fund ushtrimeve ushtarake me qëllim "që t'i ulin tensionet dhe t'i mbështesin përpjekjet e tyre diplomatike për të arritur denuklearizim të plotë të Gadishullit Korean".

Ky vendim vjen pas samitit ndërmjet presidentit Donald Trump dhe liderit verikorean, Kim Jong Un në Vietnam, ku dy liderët nuk arritën ndonjë marrëveshje.

Disa zyrtarë perëndimorë shprehën shqetësimet e tyre se dhënia fund e ushtrimeve ushtarake mund ta reduktojë gatishmërinë ushtarake në rast se rriten sërish tensionet me Korenë e Veriut. Pentagoni tha se aleatët janë pajtuar që të vazhdojnë të kenë gatishmëri ushtarake përmes stërvitjeve ushtarake në përmasa më të vogla dhe programeve të trajnimeve në terren.

Trumpi në rrezik, raporti i hetuesit të posaçëm është gati

Sipas disa njoftimeve, hetuesi i posaçëm, Robert Mueller, e ka gati raportin për përzierjen ruse në zgjedhjet presidenciale 2016 dhe se ai do t'i paraqitet këtë muaj Ministrisë së Drejtësisë

Berlin, 3 mars - Ka disa muaj që qarkullojnë spekulimet, se hetuesi i posaçëm amerikan, Robert Mueller, është duke e përfunduar raportin hetimor për ndërhyrjen ruse në zgjedhjet presidenciale të vitit 2016. Por kësaj radhe politika e Uashingtonit është në tërësi e mendimit, se raporti është gati dhe do t'i paraqitet. Me këtë lidhet shpresa, se më në fund do të merren përgjigjet e pritura për çështjen kryesore të debatuar në vend - a ka luajtur apo jo një rol aktiv kandidati i atëhershëm për president, Donald Trump dhe shtabi i tij zgjedhor në përzierjen ruse në zgjedhjet presidenciale të vitit 2016?

Së pari duhet theksuar se Robert Mueller nuk do ta bëjë publik raportin e tij. Raportin e merr ministri i Drejtësisë, William Barr, i cili do të vendosë se çfarë do të bëhet me të. Sigurisht ai do të këshillohet, për këtë herë me Shtëpinë e Bardhë dhe këshilltarët juridikë të presidentit. William Barr duhet ta informojë Kongresin për rezultatet e raportit dhe do të vendosë se çfarë do të bëhet publike.

Demokratët të shqetësuar

Thënë ndryshe, Barr vendos se çfarë do të bëhet me këtë raport. Kjo është një nga arsyet se pse emërimi i tij ishte kaq i kontestuar në Kongresin amerikan. Shumë demokratë janë të shqetësuar, se Barr ishte shprehur më parë kritik ndaj hetimeve të Muellerit. Tani ata i tremben pasojës tjetër, që Barr do të përpiqet të çaktivizojë nga ana ligjore raportin sa të jetë e mundur. Prandaj ata kërkojnë që raporti të publikohet mundësisht i plotë, vetëm ato që konsiderohen informacione sekrete mund të lihen pa u publikuar. Ata kanë marrë masa që të ftojnë funksionarë, apo ta kërkojnë nxjerrjen e dokumenteve, nëse besojnë, se Barr fsheh informacione.

Ish-avokatja Barbara McQuade shpreson që të mos ndodhë përplasja në mes të Ministrisë së Drejtësisë dhe kongresit. "Do të thosha se raporti do të publikohet në një formë, që u jep përgjigje pyetjeve kryesore: Si ndodhi që Rusia të përzihej në zgjedhjet tona dhe çfarë roli ka luajtur Shtabi Zgjedhor i Trumpit këtu? Opinioni duhet të dijë përgjigje të tilla, si Rober Mueller edhe William Barr e dinë këtë", thotë McQuade.

Ndjesia për ligjin

Parashikimi i profesoreshës së drejtësisë bazohet në qëndrimin se si Barr dhe Mueller ndjekin të njëjtat qëllime, mbrojtjen e ligjshmërisë dhe mbrojtjen e Ministrisë së Drejtësisë. Të dy republikanët e njohin njëritjetrin prej kohësh. "Mendoj se nëse ata gjejnë shkelje të ligjit, të dy do të duan që të nxjerrin secilin para drejtësisë", thotë McQuade. Por Andy Wright, ish-këshilltar i Barack Obamës dhe Al Gore, është skeptik. "Nga njëra anë Barr përfaqëson Ministrinë e Drejtësisë si institucion dhe detyra e tij është ta mbrojë ministrinë nga një president, që me gjasë përpiqet me çdo çmim ta shndërrojë në policinë e tij", thotë themeluesi i blogut "Just Security". Nga ana tjetër, ai ka thënë vërtet gjëra shqetësuese për hetimin e Muellerit, kur nuk i njihte të gjitha faktet. Sipas ish-këshilltarit të presidentit Obama, nuk mund të thuhet me saktësi se çfarë roli do të luajë Barr.

I zgjeruar apo i kufizuar te më e domosdoshmja?

Po ashtu nuk dihet se sa i detajuar do të jetë raporti i Muellerit. Ai mund të jetë i zgjeruar, por edhe i reduktuar në minimum. Nëse do të merrej parasysh qëndrimi i zëvendësministrit të Drejtësisë, Rod Rosenstein, ku detyra e ministrisë është të përqendrohet te personat që vërtet do të akuzohen, atëherë raporti i Muellers do të përqendrohet fort te veprimet penalizuese. Një qëndrim i tillë i përgjigjet edhe rrjedhës së deritanishme të hetimit, të kufizuar te ndërhyrja ruse. Pavarësisht se çfarë shkeljesh do të paraqiten, raporti mund të jetë zhgënjyes për ata që kanë pritur zbulime që shkojnë thellë.

Akuza përmes rrugëve anësore

Edhe sikur vetë Mueller të arrijë në konkluzionin, që Trumpi mund të akuzohet për një vepër penale, kjo nuk ka për të ndodhur. Ministria e Drejtësisë ka qëndrimin se një president i mandatuar nuk mund të akuzohet. Nëse Muelleri e akuzon Trumpin për një vepër penale, për të cilin ai nuk nxirret para drejtësisë, sa kohë është në post, atëherë Kongresi mund të thërrasë një plan tjetër për veprim, procedurën e largimit nga posti, kjo do të ishte pastaj një ndërmarrje politike, jo juridike. Por, ka edhe një arsye tjetër pse Trumpi nuk mund ta shohë si të përfunduar historinë. Edhe nëse raporti i Muellerit nuk e nxjerr atë fajtor, Mueller kishte dorëzuar pjesë të hetimit tek institucione të tjera të drejtësisë si në Nju Jork, dhe ka një sërë hetimesh që zhvillohen paralelisht për aktivitetet e Donald Trumpit si president dhe njeri i biznesit. *(dw).*

Netanyahu dënon sulmin ndaj memorialit hebre në Francë

Tel-Aviv, 3 mars - Kryeministri i Izraelit, Benjamin Netanyahu, ka dënuar sulmin në një memorial të Holokaustit në qytetin francez të Strasburgut. Netanyahu dënoi dëmtimin e monumentit që është vendosur pranë një sinagoge të shkatërruar nga nazistët më 1940.

Policia franceze të shtunën ka nisur hetimin lidhur me këtë incident.

Ky incident vjen në kohën kur sulmet anti-semite kanë shënuar rritje muajt e fundit në Francë. Muajin e kaluar në Francë ishin dëmtuar rreth 80 varreza të hebrenjve, ku mbi to ishte ngjyrosur me sprej simboli i svastikës.

Netanyahu u bëri thirrje të gjithë udhëheqësve të shteteve që të bashkohen për ta denoncuar antisemitizmin. "Mënyra e parë për ta luftuar antisemitizmin është denoncimi", tha ai.

LIBRI I LUFTËS SË KOSOVËS

Të nderuar mysafirë,
Dashamirë të librit,
Mirë se keni ardhur në këtë festë të madhe të librit në fillim të muajit mars,

Berat ARMAGEDONI

Sot, bashkërisht me ju, po promovojmë librin e gazetarit të Radio Televizionit të Kosovës, gazetarit të luftës dhe të paqes, Nuhi Bytyçit, shkruar hëm në kohën e paraluftës, hëm në kohën e luftës, hëm në të pasluftës. Shkruar me shkas: për ta kujtuar çmimin e lirisë së sotme paguar për dhjetëra vjet.
Pjesa më e madhe e librit është e mbushur me luftë, prandaj edhe quhet "Libri i luftës" dhe është shkruar dhe botuar në shenjë nderimi dhe kujtimi për Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, në shenjë nderimi dhe kujtimi për heronjtë, dëshmorët, martirët, viktimat civile, invalidët, veteranët dhe për udhëheqësit politikë, diplomatikë dhe ushtarakë të UÇK-së.
"Libri i luftës" është libër autobiografik, po është edhe libër biografik. Në të është jetëshkrimi i autorit, i familjes së tij, po është edhe shkrimi për Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, për udhëheqësit e saj, për qindra heronj, për qindra dëshmorë, për dhjetëra viktima, për shumë beteja, për shumë ushtarë të mbetur invalidë, për shumë veteranë që s'kanë kursyer asgjë për lirinë që gëzojmë dhe që gëzojnë sot.
Po qe se nuk ju bën shumë përshtypje puna e gazetarëve në ditët e sotme, duhet t'ju bëjë kjo tjetra: gazetaria në kohë lufte, në të gjithë territorin e Kosovës, edhe në një pjesë të Shqipërisë, të Maqedonisë, të diasporës, e cila, për shkak të rrjedhës së rrëfimit, tregohet si përrallë, veçse kësaj përralle duhet t'i zini besë sepse ka dëshmi dhe ka fotografi. Së këndejmi, po qe se nuk jeni të interesuar të dini për një gazetar dhe një kameraman çfarë kanë bërë në luftë, duhet të interesoheni çfarë kanë bërë komandantët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës për çlirimin e Kosovës dhe për informimin e opinionit publik nëpërmjet atyre pak medieve të informimit që kishte në kohë lufte e për ata pak gazetarë që mezi shkonin në zona të luftës, sepse përtonin, sepse nuk donin ta rrezikonin jetën e vet për ta informuar publikun.
"Libri i luftës" ka dymbëdhjetë kapituj. Shkrimi nis në vendlindjen e autorit, me shkollimin e autorit në shkollën e fshatit, pastaj vazhdon në fshatin tjetër përbri tij, pastaj në qytetin e Prizrenit.
Zë vend në libër, në dhjetëra faqe, edhe punësimi i autorit në Radiotelevizionin e Prishtinës, në gazetën "Rilindja" dhe raportimet e vështira të tij për këto dy media, në rrethana të censurës nga regjimi serb në Kosovë, për ta informuar opinionin vendor dhe atë botëror për të vërtetën shqiptare. Dhe, teksa lexon pjesë të ditarit dhe të kujtimeve të tij në këtë libër, të mbushet mendja të thuash dhe të diskutosh me vetveten dhe me të tjerët pse ka rrezikuar kaq shumë kur paska qenka kaq e rrezikuar jeta e tij.
Nuhiut këtë pyetje ia kam bërë edhe kur po e përgatisnim librin për shtyp. Dhe, ashtu si në një fjali në libër, më është përgjigjur edhe me gojë: "Pse duhet të jetoja unë kur për liri dhe pavarësi, edhe pa u shpallur lufta, vriteshin shqiptarët?! Pse duhet të jetoja pasi ranë Jasharët?! Pse duhet të jetoja pasi u bënë masakra në Abri, në Meje, në Reçak?!"
Nuhiu, pavarësisht prej shumë rreziqeve që pati në jetë, pati fatin të jetojë dhe ta shkruajë dhe ta publikojë këtë libër, i cili i bën nder të madh, para gjithë të tjerëve, Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, organizimin dhe luftën e së cilës e ka përcjellë, me një laps dhe me një diktafon, me një aparat dhe me një kamerë dhe një kameraman, aty ku është zhvilluar luftë e ashpër, aty ku janë vrarë çlirimtarë, sidomos në Drenicë, Llapushë, Podrime, Dukagjin.
Të njëjtën punë, të gazetarisë në kohë lufte, Nuhiu nuk e ka bërë vetëm në Kosovë. E ka bërë edhe tjetërkund. Sapo ka krisur pushka e parë në Maqedoni, edhe pa e ngarkuar me punë udhëheqësit e RTK-së, ia ka mësyrë asaj, ka bërë dhjetëra kronika, dhjetëra intervista, qindra fotografi. Vetëm planifikim të luftës nuk ka bërë.
"Libri i luftës", edhe pse tash tingëllon klishe, sepse sot e jashtëzakonshmja nuk ka ndonjë masë vlerësuese, për shkak se e kanë zhvlerësuar kush i pari e kush i fundit që flet edhe për ata libra që s'kanë kulturë të librit dhe që s'janë libra, njëmend është libër i jashtëzakonshëm dhe është libër atraktiv. Kur mungojnë fjalët, shpjegimet për ngjarjet i plotësojnë fotografitë. Jo pak fotografi, po 1 000 copë. Mbase 300 prej tyre i keni parë në libra të tjerë e në media fizike dhe elektronike, po 700 të tjera duhet t'i shihni sepse flasin shumë, për shumëçka njerëzore dhe të panjerëzishme. Disa prej tyre kanë dhembje të madhe sepse prezantojnë masakrat e serbëve bërë ndër shqiptarë, edhe të foshnjave në djep, edhe të plakave e të pleqve të paralizuar; disa të tjera prezantojnë gëzime sepse festohet çlirimi i Kosovës.
Nëse dëshironi të dini diçka më shumë për organizimin dhe për detyrat e udhëheqësve të UÇK-së, ato i keni në këtë libër. Pa dyshim ky libër është shkruar për ta ruajtur dhe freskuar kujtesën kombëtare. Meqë po e promovojmë sot, pak ditë para ngjarjeve të përvjetorit të marsit të flijimit të Jasharëve, është edhe një përmendore kujtese dhe nderimi për jetët dhe shpirtrat e tyre.
Ky libër, prej 800 faqesh, është enciklopedik.
Ka mbi 5 000 persona.
Mbi 30 personazhe.
Mbi 50 beteja.
Mbi 20 fitore.
Mbi 500 heronj, dëshmorë, viktima të cilët i ka parë autori e me disa prej të cilëve, sa kanë qenë gjallë, ka realizuar intervista dhe shkrepur fotografi edhe në llogore.
Mbi 500 fotografi me temë atdhetare, sociale, politike, demokratike.
Mbi 500 fotografi historike që kurrë më parë s'i keni parë e që mezi s'prisni t'i shihni.
Ka dramë.
Ka tragjedi.
Ka komedi.
Ka tragjikomedi.
Janë në këtë libër disa deklarata të Ibrahim Rugovës, Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Ramush Haradinajt, Fatmir Limajt, Rrustem Mustafës, Jakup Krasniqit për luftën dhe lirinë, udhëtimet e autorit me ndonjërin prej tyre nëpër Kosovë. Ka edhe përplasje me ndonjërin prej këtyre, ashtu sikurse me ndonjërin ka miqësi më të madhe e që është më e dukshme.
I gjeni, po ashtu, mbështetësit e UÇK-së dhe kundërshtarët e saj.
UÇK-në dhe FARK-un, pijet dhe ushqimet e ushtarëve të tyre. Edhe paratë e tepërta dhe mungesën e tyre. Edhe përçarjet mes tyre.
Ky libër që është shkruar për luftën nuk do të botohej pa përkrahjen e Ministrisë së Kulturës, të ministrit Kujtim Gashi dhe të afaristit Lazim Destani, të cilët i falënderoj për mbështetjen!



(Autori është drejtor i shtëpisë botuese "Armagedoni")

E rrallë

Qindra sorra mblidhen në një park makinash në Teksas

Pamjet e frikshme tregojnë qindra sorra që mblidhen në një park makinash në Teksas, një skenë e ngjashme me filmat horrorë. Videoja tregon qindra sorra në një dyqan në Hjuston të Teksasit. Vëzhgimi i rrallë ndodhi

më 14 dhjetor të vitit të kaluar dhe pamjet janë publikuar tash.

FOTO E DITES

Dy burra serfojnë natën në plazhin Cap Frehel në Plevenon të Francës. Fotografia: Loïc Venance. /AFP/

E jashtëzakonshme

Aligatori që bëri lëmsh rrjetin, peshon 317 kilogramë dhe është katër metra i gjatë

Një fotografi e një aligatori të madh prej 317 kilogramësh, me gjatësi prej katër metrash, u bë virale në rrjete sociale dhe shumë njerëz nuk besonin se imazhi ishte i vërtetë. Zvarraniku gjigant u shpëtua nga konserva-

torët nga një gropë ujitje pranë Liqenit Blackshear në Gjeorgji të ShBA-së.

BARSOLETA E DITËS

- Babi, ç'është ligji i gravitetit?
- Të them të drejtën nuk e di. Ku ka kohë babi yt t'i ndjekë punimet e Parlamentit dhe të mësojë për të gjitha ligjet që ai miraton?

Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Vetem gjate vikendit në ora 14:00

"SHEEP AND WOLVES" 3D

I Animuar/Aventure/Komedi; 1 ore 25 min

Rolet: Graham Halstead, Vladimir Chuprikov
Regjia: Vladimir Nikolaev

Vetem gjate vikendit në ora 16:00

"ALITA: Battle Angel" 3D

Aksion/Aventure/Romanse; 2 ore 02 min

Rolet: Rosa Salazar, Christoph Waltz, Jennifer Connelly, Mahershala Ali, Ed Skrein, Jackie Earle Haley, Keean Johnson, etj.
Regjia: Robert Rodriguez

Në ora 18:00

"BERLIN, I LOVE YOU"

Dramë/Romansë; 2 ore

Rolet: Keira Knightley, Helen Mirren, Luke Wilson, Mickey Rourke, Jenna Dewan
Regjia: Dianna Agron, Peter Chelsom, Claus Clausen

Në ora 20:00 dhe 22:00

""SERENITY"

Dramë/Triller; 1 orë 46 min

Rolet: Matthew McConaughey, Anne Hathaway, Diane Lane, Jason Clarke, Djimon Hounsou, Jeremy Strong, etj.

Regjia: Steven Knight

Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.

DASHI
Mos u trembni nëse duhet të ndryshoni në çast të fundit projektet tuaja. Ndonjëherë ndryshimet janë shumë për mirë.

DEMI
Keni lejuar që problemet e punës të bëhen pjesë e jetës suaj personale dhe kjo do t'ju krijojë mjaft ngërç në komunikimin me partnerin.

BINJAKËT
Dikush ju ka përfshirë pa dëshirën tuaj në një marrëdhënie mjaft të komplikuar. Të pamundur për të dalë, do të bëheni pjesë e rrjedhës.

GAFORRJA
Sot ndiheni shumë mirë me veten sepse keni zbuluar çelësin se si të jeni të lumtur edhe nga gjërat e vogla që mbushin ditën tuaj.

LUANI
Situatat që po ju ndodhin kohët e fundit janë shumë të ndikueshëm nga gjendja juaj emocionale. Mundohuni ta ndani arsyen nga ndjenja.

VIRGJËRESHA
Përvoja juaj ju ka mësuar të mos flisni para kohe për çështje që nuk i njihni mirë. Heshtja tregon më shumë se fjalët.

PESHORJA
Në sipërfaqe duket sikur jeni shumë në rregull, por në brendësi ka një çështje që po ju shqetëson dhe një person që tërheq gjithë vëmendjen tuaj.

AKREPI
Ju mungon përqendrimi, por duhet patjetër të sforcoheni sepse një projekt i caktuar që keni marrë përsipër kërkon gjithë vëmendjen tuaj.

SHIGJETARI
Megjithëse e keni të qartë se kush do të jetë e ardhmja juaj, përsëri doni të jeni të sigurt nga ana financiare për ta përballuar.

BRICJAPI
Gjithçka që mund të bëni sot është ta kënaqni veten tuaj duke i bërë sa më të këndshme çastet e ndryshme që do t'ju ofrojë dita.

UJORI
Respektin që kanë të tjerët karshi jush e keni vendosur më shumë mund. Një keqkuptim i vogël mund të prishë të gjithë imazhin e krijuar.

PESHQIT
Një ditë e mbushur me kënaqësi të vogla që do t'ju bëjnë më tolerant dhe më të dashur me familjen tuaj. Kishit kohë pa u ndier kështu.

Travis Scotti zhduket nga "Instagram"-i pas akuzave për tradhti

Travis Scotti nuk është më në "Instagram" pas thashethemeve që po qarkullojnë rreth marrëdhënies së tij me Kylie Jennerin. Reperi 26-vjeçar u akuzua për tradhti ndaj Kylie këtë javë. "TMZ" ka raportuar se ai anuloi edhe koncertet këtë javë për ta riparuar marrëdhënien e tij, jo për shkak se ishte i sëmurë. Përfaqësuesi i reperit lëshoi një deklaratë duke mohuar se ai kishte tradhtuar, por shumë fansa kanë hyrë në "Instagram" për të folur kundër yllit të muzikës. Kylie dhe Travis janë prindër të një vajze njëvjeçare me emrin Stormi.

Miley Cyrus tregon se kë e puthi për herë të parë



Këngëtarja amerikane Miley Cyrus ka thënë se puthja e saj e parë ka qenë me një vajzë. Miley këtë e ka theksuar në shoun televiziv "RuPaul's Drag Race". "Puthja ime e parë ishte me një vajzë në shkollën e mesme. Dhe askush nuk ka mundur ta kuptonte në Nashville këtë", ka pohuar Cyrus.

Paris Hiltoni: Unë nuk kam kohë për të dashur

Biznesmenja Paris Hilton është parë duke flirtuar me reperin Machine Gun Kelly në një ndejë në Los Anxhelos. Në një intervistë për "The Mirror", Hilton ka thënë se nuk ka kohë për dashuri. "Unë nuk kam kohë për dashuri tani. Unë mezi kam kohë për veten time", është shprehur Hiltoni.

Zayn Malik e tregon publikisht dashurinë ndaj Gigi Hadidit



Zayn Malik dhe Gigi Hadid duket se janë rikthyer sërish bashkë. Këngëtari 26-vjeçar dhe modeluesja 23-vjeçare kanë qenë në një marrëdhënie të vazhdueshme dhe të pandërprerë në vitet e fundit. Vitin e kaluar ata u ndanë, por janë parë sërish. Zayn ka postuar të shtunën në "Twitter" disa fjalë për ta treguar publikisht dashurinë për Gigin. "Gigi Hadid, të dua", ka shkruar Zayn.

Historia e spiunes që punoi për llogari të rusëve

Maria de la Eras Afrika, pseudonimi i "Patria", spanjolle, lindi më vitin 1910 në qytetin Tetuan në Marok, në familjen e një oficeri spanjoll të rënë nga vakti. Pas vdekjes së babait në vitin 1916, nisën për të vështirësitë e jetës.

Pasi u kthye në Spanjë, ajo u pranua në Partinë komuniste dhe mori pjesë në kryengritjen e minatorëve në provincën Asturia. Që nga viti 1936 me fillimin e luftës civile në Spanjë, mori pjesë në luftimet kundër trupave frankiste, ishte delegate e Partisë komuniste të Spanjës në qeverinë e Frontit Popullor. Bashkëpunimin me zbulimin e jashtëm ajo e filloi në vitin 1937, kur rezidenti me pseudonimin "Suedezi" e rekrutoi duke i vënë pseudonimin Patria. Ajo realizoi shumë detyra zbuluese në disa shtete.

Nga Meksika atë e thirrën urgjent për shkak të zhdukjes së "Suedezit" në vitin 1938, nga frika e tradhtisë së tij të "supozuar". Pas disfatave të Republikanëve në Spanjë, "Patria" shkoi në Bashkimin Sovjetik ku qëndroi në rezervë të organeve të sigurimit të shtetit. Filloi Lufta e Madhe Patriotike . "Patria" kërkonte të shkonte në front, por atë e morën për ta përgatitur si radiste.

Në vitin 1942 e hodhën në prapavijë të ushtrisë gjermane, ku ajo u bë radiste e çetës partizane me rëndësi të veçantë "Fitimtarët", që komandohej nga heroi i Bashkimit Sovjetik D.N. Medvedjev. Mori pjesë në operacionet luftarake partizane, duke shfrytëzuar eksperiencën e saj luftarake në Spanjë. Për pjesëmarrje aktive në lëvizjen partizane gjatë luftës, ajo u dekorua me shumë urdhra.

Më 1944 u kthye në Moskë. Meqë në Amerikën latine nevojitej një zbuluese me eksperiencë "Patria" iu nënshtrua një përgatitjeje speciale. Në vitin 1946 ajo ndodhej në gjendje ilegale, në një nga vendet evropiane, duke pritur kushtet për të kaluar në Amerikën Latine. Përpara nisjes e thirrën në Moskë, për shqyrtimin e planit të vendosjes dhe për detyrën për krijimin e pikës së radiondërlidhjes në një nga shtetet amerikano-jugore.

Një nga detyrat pas punës si radiste ishte dhe rekrutimi nga ana e saj përmes ndihmës e ish legalit antifashist italian të quajtur "Luftëtari". Ata punuan bashkë për punën zbuluese. Eksperienca e tyre e pasur siguroi zgjidhje të drejta të detyrave të vështira që u ishin ngarkuar, ndër të tjera dhe garantimin nga "Patria" të radiondërlidhjes së sigurt të rezidenturës me Qendrën, në një distancë aq të madhe që ndante kontinentin amerikan nga Moska.

Bashkëpunimi i tyre rezultoi suksesshëm. Ata u miqësuan dhe pas disa kohësh kërkuan lejen e Qendrës që të martoheshin bashkë. Sigurisht që Qendra nuk i kundërshtoi. Për fat të keq në vitin 1964 "Luftëtari" vdiq nga sëmundje e plagë të vjetra të marra gjatë luftës. "Patria" e varrosi bashkëshortin në tokë të huaj dhe akoma për disa vjet drejtoi në mënyrë të pavarur punën e rezidenturës. Ajo u kthye në Moskë në vitin 1967 dhe mbante gradën e kolonelit. Ajo mbylli sytë në 8 mars të vitit 1988. Në varrin e saj në Hovansk, shkruhet :"Kolonel Afrika De Las Eras, punonjës i nderuar i organeve të sigurimit të shtetit".

/Gazeta Shqip

BAJAMET, "SPËRKATËSIT" E ARTERIEVE

Ja pse (dhe sa duhen ngrënë)

Që ky frut i thatë na bën mirë nuk është një lajm i ri, por tani duhet ët dimë se çdo lloj ka avantazhe të veçanta. Sidoqoftë, është e ndaluar të konsumosh doza të mëdha, për shkak se ato janë shumë kalorike. Rekomandohen në fund të vaktit, si një meze e lehtë, në mëngjes, për të pasuruar një pjatë: frutat e thata janë të mira për shëndetin tuaj dhe nuk ka dyshime për këtë.

Por, që kjo bajame mund të jetë një "pastrues" i shkëlqyer antikolesteroli është një risi: në fakt duket se po të hash cdo ditë nga pak është e lidhur me një përmirësim në funksionimin e kolesterolit "të mirë" HDL, ai që analizoi vazot për të mbledhur dhe shkatërruar kolesterolin e tepërt që mund të "bllokonte" arteriet që favorizonin infarktin.

Këtë e tregoi në një grup vullnetarësh Penny Kris-Etherton, një nutricionist në Universitetin e Pensilvanisë, i cili donte të hetonte se çfarë ndodh me kolesterolin HD me një konsum të rregullt të bajameve.

Efektet

"Ky lloj fruti ka efekte pozitive në nivelet e kolesterolit në përgjithësi, por deri më tani nuk dimë shumë nga veprimi specifik në HDL, i cili në kundërshtim me LDL (kolesteroli "i keq") ndihmon në reduktimin e rrezikut kardiovaskular", shpjegoi Kris-Etherton. Për të sqaruar, një grup vullnetarësh iu nënshtruan analizave të gjakut dhe pastaj për gjashtë javë në një dietë që përfshinte 43 gram bajame si snacks (pak më shumë, pastaj, nga "doza" standarde e cila është rreth 30 gramë, e barabartë me rreth njëzet bajame); pastaj, pas përsëritjes së testeve të gjakut, të njëjtët pjesëmarrës ndoqën një dietë të njëjtë, por hëngrën një fetë banane si një meze të lehtë dhe më pas u nënshtrohen testeve përsëri.

Mekanizmi

Gjetjet e publikuara në 'Journal of Nutrition' në shkurt, tregojnë se frutat e thata jo vetëm që rritin nivelet e HDL, por përmirësojnë funksionalitetin: "Grimcat Hdl janë shumë të vogla kur ato formohen, – vëzhgon hulumtuesi. – Ata janë si qese plehrash, fillimisht të zbrazëta dhe pastaj më të gjera dhe më rrumbullake sa ata mbledhin kolesterolin Ldl në shumë nga vazot për ta marrë atë në mëlçi. HDL është e ndarë në pesë "popullata" të ndryshme: kemi vlerësuar entitetin e secilit për të kuptuar nëse ajo e HDL më të "fryrë" të kolesterolit ishte më e bollshme pas dietës me bajame si një rostiçeri, një shenjë e një rritje të funksionalitetit e vetë HDL-së. Kjo ndodh vetëm në këtë mënyrë: pjesa e kolesterolit më të madh Hdl rritet me 19 për qind, funksionaliteti me 6.4 për qind. Kjo do të thotë se Hdl është duke bërë edhe më mirë se zakonisht puna e saj si një pastruese, duke rikuperuar më shumë kolesterol në rreth".

Rreziqet kardiovaskulare

Tek ato që janë obezë ose mbipeshë, bajamet gjithashtu reduktojnë kolesterolin Ldl me 7 për qind, siç tregohet nga një studim tjetër nga i njëjti studiues i paraqitur në 'Journal of the American Heart Association' javët e fundit: nuk bëhet fjalë për një kurë, por është megjithatë, një mënyrë e mirë për të përmirësuar profilin e rrezikut kardiovaskular edhe falë fibrave, vitaminës E dhe yndyrave polyunsaturated, nga të cilat bajamet janë të pasura. "Ata janë një meze e lehtë e përkryer, nëse hani me moderim në vend të një rostiçerie me ushqime me vlerë të ulët ushqyese", thotë Kris-Etherton.

Jo më shumë se tridhjetë gramë në ditë

Thirrja për doza është e domosdoshme për shkak se bajamet, si të gjithë frutat e thata, janë shumë energjike (600 kalori për hektogram): ideale është të marrësh 30 gramë fruta pa guaskë ose 20-25 nëse ndjek një dietë të ulët kalorike. Më mirë pastaj të alternoni lloje të ndryshme të frutave të thata, pasi secili ka karakteristika të veçanta: bajamet, për shembull, kanë një fuqi më të ulët antioksiduese se arrat dhe lajthitë, por ato janë më të pasura me vitaminë E dhe proteina bimore. *Gazeta Shqip*

Sport

QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE					
HAMBURGER - GREUTHER FURTH	1	LIVORNO - BENEVENTO	1	LE HAVRE - METZ	2

Ademi, Serbisë: Veç FFK-ja mund të organizojë gara në Kosovë

Kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi, ia ka rikujtuar edhe një herë Serbisë, se FFK-ja është organi i vetëm që ka të drejtën e organizimit të futbollit në gjithë territorin e Republikës së Kosovës. "FFK-ja i ka ndarë rrugët me Serbinë qysh në vitin 1991, ndërsa kjo ndarje është forcuar dhe vulosur pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës më 2008. FFK-ja tashmë është pjesë me të drejta të plota në UEFA dhe FIFA dhe është i vetmi organ që ka të drejtën e organizimit të futbollit në gjithë territorin e Republikës së Kosovës", ka thënë Ademi

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 3 MARS - Kohët e fundit janë shtuar zërat se Serbia do të organizojë zgjedhje në të ashtuquajturën Federatë Serbe të Futbollit për Kosovë. Lidhur me këtë ka reaguar kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi, i cili ka rikujtuar edhe një herë faktin se FFK-ja i ka ndarë rrugët me Serbinë qysh në vitin 1991, kurse tash është organi i vetëm që ka të drejtën e organizmit të futbollit në territorin e Kosovës. "FFK-ja i ka ndarë rrugët me Serbinë qysh në vitin 1991, ndërsa kjo ndarje është forcuar dhe vulosur pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës më 2008. FFK-ja tashmë është pjesë me të drejta të plota në UEFA dhe FIFA dhe është i vetmi organ që ka të drejtën e organizimit të futbollit në gjithë territorin e Republikës së Kosovës. Së këndejmi, çdo tendencë për ta themeluar një të ashtuquajtur Federatë Serbe të futbollit për Kosovë, për të organizuar gara në futboll, është e papranueshme dhe e konsiderojmë ndërhyrje të drejtpërdrejtë në autonominë e FFK-së. Ndaj FFK-ja nuk do të lejojë në asnjë mënyrë që një organizatë e tillë ilegale të organizojë gara në territorin e vet", ka thënë Ademi, i cili më pas ka kërkuar nga Serbia që të heqë dorë sa më parë nga këto veprime, të cilat, sipas Ademit, nuk mund ta dërgojnë askund. "Serbia në këtë kohë po proklamon pajtimin me shqiptarët dhe njohjen e Kosovës, por veprimet e saj flasin të kundërtën e kësaj. Madje ajo shkon aq larg sa përpiqet jo vetëm në aspektin politik, por edhe sportiv ta dëmtojë Kosovën dhe po punon në çdo segment ta defaktorizojë dhe angazhohet për zhbërjen e shtetit të Kosovës. Kjo nuk do të ndodhë në asnjë rrethanë dhe për asnjë çmim. Ndaj i bëjmë thirrje Serbisë që menjëherë të heqë dorë nga këto veprime, sikur që i ftojmë të gjitha organet tona shtetërore, në veçanti MKRS-në dhe KOK-un, të reagojnë ashpër për parandalimin e këtyre veprimeve", ka shtuar ai.

Kryetari i FFK-së ka kërkuar edhe nga UEFA dhe FIFA të reagojnë ndaj këtij veprimi të Serbisë, kurse ka konfirmuar se Federata e Futbollit e Kosovës është e përkushtuar të punojë edhe më tutje për përfshirjen e futbollistëve dhe ekipeve serbe në garat e futbollit të Kosovës. "Sikurse ne, duhet do të reagojnë edhe dy shtëpitë e futbollit, ajo Evropiane dhe Botërore, pjesë e të cilave është FFK-ja, që t'ia tërheqë vërejtjen Serbisë që t'i ndalojë këto lloj veprimesh. FFK-ja është e përkushtuar të punojë edhe më tutje për përfshirjen e futbollistëve dhe të ekipeve serbe në garat e futbollit të Kosovës, duke i trajtuar në mënyrë të barabartë të gjithë qytetarët e Kosovës. Ne duam të besojmë, se të gjitha institucionet e Kosovës politike dhe sportive do t'i ndërmarrin të gjitha hapat e nevojshëm për parandalimin e veprimeve të tilla, sikurse besojmë dhe shpresojmë se Serbia do të ndalojë me veprime të tilla edhe për të mirën e komunitetit serb", ka përfunduar Ademi.

Llapi dhe Feronikeli sulmojnë FFK-në dhe kryetarin Ademi

Dy skuadrat që po luftojnë për titull të kampionit në elitë, Llapi dhe Feronikeli, e kanë akuzuar Federatën e Futbollit dhe kryetarin e saj, Agim Ademi, që po e mbështet Prishtinën

EPOKA E RE Liridon ZEQIRI

PRISHTINË, 3 MARS - Skuadra e Llapit të shtunën e ka akuzuar Federatën e Futbollit të Kosovës dhe kryetarin e saj, Agim Ademi. Sipas skuadrës nga Podujeva, kryetari i FFK-së i ka dhënë Prishtinës 38 mijë euro premi për ta mposhtur skuadrën e Llapit. "Nuk e kemi mposhtur vetëm Prishtinën, por edhe Federatën e Futbollit të Kosovës, e cila i ka dhënë premi 38 mijë euro për ta mposhtur Llapin. Të premten, një ditë para ndeshjes, presidenti i Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi, i pagoi FC Prishtinës premi në vlerë 38 mijë euro. Kjo nuk ndodh askund në botë. Kjo është për hetuesi. Shtrohet pyetja për Komitetin Ekzekutiv a ka raste të tjera kur ndodh e njëjta gjë dhe a po ndodhin me leje të tij?", thuhet në postimin e Llapit në faqen zyrtare në "Facebook".

Akuzave të Llapit të dielën i është bashkangjitur edhe skuadra e Feronikelit. Kjo e fundit e ka pyetur kryetarin e Federatës së Futbollit se a duhet Feronikeli të luftojnë ndaj të gjithëve apo qëllimi është të fundoset klubi më profesional në Kosovë. "Shihet se Ademi po e dëshironte shumë fitoren e Prishtinës, pasi ky çmim nuk është aspak i vogël. Shtrohet pyetja, zotëri Ademi, si mund t'ia dalim ne si klub edhe kundër juve? Apo mos dëshironi që Feronikeli të luftojë i vetëm kundër të gjithëve? Apo mos keni ambicie, që klubin më profesional që keni në Superligë, ta fundosni me marrëveshje 'pas shpine'?", thuhet në reagimin e Feronikelit.

Skuadra nga Drenasi ka shkuar edhe më larg, duke komentuar edhe rastin e incidentit të portierit të KEK-ut, i cili e goditi sulmuesin Kastriot Rexha në fyt, por edhe rastin që sulmuesi i Prishtinës, Basid Khalid, e godet me grusht lojtarin e Llapit, Bujar Idrizin. "Pas gjithë kësaj rrëmuje, Feronikeli fiton te KEK-u, kurse Llapi i merr tri pikë Prishtinës dhe diferenca mes Feronikelit e Prishtinës është pesë pikë sepse, zotëri Ademi, futbolli gjithmonë triumfon. Apo mos po kthehet FFK në FFP (Federata e Futbollit të Prishtinës)?", thuhet, ndër të tjera, në reagimin e Feronikelit.

FFK-ja, Llapit: Mos shpif, kërko falje!

Federate e Futbollit e Kosovës (FFK) i ka reaguar skuadrës së Llapit lidhur me akuzat që i ka bërë rreth asaj se kryetari i FFK-së, Agim Ademi, i ka dhënë premi prej 38 mijë eurosh Prishtinës për ta mposhtur Llapin në derbin e zhvilluar të shtunën në Podujevë. FFK-ja ka mbetur e habitur me akuzat e Llapit, kurse i ka bërë apel kryesisë së klubit të kërkoj falje. "Ne si FFK kërkojmë nga kryesia e FC 'Llapi' që të distancohet dhe të bëjë kërkim falje për të pavërtetat e thëna dhe akuzat e turpshme në profilin zyrtar të klubit në 'Facebook' ndaj presidentit Agim Ademi dhe KE të FFK-së. FFK-ja gjithmonë ka qenë, është dhe do të jetë e njëjtë dhe e drejtë për të gjitha klubet dhe do t'i ndihmojë ato njësoj e në mënyrë të barabartë për aq mundësi sa ka dhe aq mjete sa u takojnë nga kontrata e sponsorimit me IPKO-n dhe nga të drejtat televizive, por asnjëherë nuk do të privilegjojë asnjë klub dhe kurrë nuk do të ketë ndihma apo premi dhe para që nuk u takojnë. Shuma që përmendet në tekstin e FC "Llapi" është e pakuptimtë, tendencioze dhe qëllimkeqe", thuhet në reagimin e Federatës së Futbollit të Kosovës. "Deklarata e FC 'Llapi' është tejet e ulët dhe shpifëse por, fatkeqësisht, ky është niveli në të cilin gjendemi. Federata nuk është për të bërë pazare, por për të organizuar gara dhe për të pasur drejtësi për të gjitha klubet. Ndaj të gjithë atyre që do të mundohen të bëjnë pazare FFK-ja do të jetë e pakompromis dhe do t'i luftojë me këmbëngulësi me të gjitha mjetet, ashtu sikur çdo padrejtësi dhe parregullsi tjetër që mund të shfaqet në futbollin tonë. Presidenti Ademi dhe organet e tjera të FFK-së janë zotuar se do ta nxjerrin gjithmonë më të mirën prej futbollit dhe se do të fitojë gjithmonë ai që është më i miri", thuhet në reagimin e FFK-së.

Prishtina, fituese e Kupës

Prishtina e ka turpëruar Rahovecin në "Mizahir Isma" për ta fituar Kupën e Kosovës. Skuadra nga kryeqyteti dominoi gjatë gjithë takimit në sallën e sporteve "Mizahir Isma" që ishte e stërmbushur me tifozë, duke triumfuar me rezultatin 96:60. Prishtina ishte dukshëm më e mirë se vendasit, që kanë një skuadër kryesisht me basketbollistë të rinj. Skuadra nga Kryeqyteti, e mbylli pjesën e parë me 16 pikë diferencë, 48:32, kurse në fund diferenca shkoi deri në 36 pikë, duke triumfuar 96:60.

Kastrioti fiton edhe derbin me Prishtinën

PRISHTINË, 3 MARS - KH Kastrioti ka ruajtur epërsinë prej dy pikëve në krye të tabelës, duke e fituar edhe derbin e xhiros së 18 të Superligës së Kosovës në hendboll (meshkujt). Skuadra ferizajase e mposhti Prishtinën në kryeqytet me rezultat 24:20. Pas pjesës së parë Kastrioti kishte plot gjashtë gola epërsi, 14:8. Kastrioti pjesën e rregullt të garave e përfundon në vendin e parë me 34 pikë. 32 pikë i ka Besa Famgas, ndërsa Prishtina renditet e treta me 28 pikë. Gara për titull do të vazhdojë tani në Superligën A, ku gjashtë skuadrat e para do të luajnë edhe dhjetë xhiro të tjera, e më pas edhe në plejof. Terziqi me 9 gola ishte më efikasi te Kastrioti. Nga 4 gola i shënuan Prekazi dhe Rajatoski, kurse Bajqinovci ishte më efikasi te skuadra e Prishtinës me 7 gola. Në këtë xhiro Besa Famgas fitoi shumë thellë ndaj Samadrexhës me rezultat 41:9. Derbi rajonal në mes të Trepçës dhe Vushtrrisë, i cili u luajt në Mitrovicë, u fitua nga vushtrriasit me një gol dallim, 22:21.

Llapi fiton derbin ndaj Prishtinës, Feronikeli përforcon kreun

PRISHTINË, 3 MARS - Skuadra e Llapit e ka fituar derbin ndaj Prishtinës me rezultat 1-0. Ndeshja e zhvilluar në stadiumin "Zahir Pajaziti" ishte mjaft e fortë dhe atmosfera në tribuna ishte e jashtëzakonshme. Fituesin në këtë ndeshje e përcaktoi goli i Ahmet Januzit në minutën e 47, i cili e mposhti portierin Bekaj pas një pasimi të mirë nga Mentor Zhdrella. Pas kësaj fitore Llapi mbetet në garë për titull me shtatë pikë pas skuadrës lidere, kurse Prishtina bën edhe një hap pas drejt titullit të kampiones në elitë, derisa tash ka pesë pikë më pak se Feronikeli. Skuadra lidere, Feronikeli, përforcohet në pozitën e parë me fitoren e arritur ndaj KEK-ut (0-1). Golin e fitores për skuadrën nga Drenasi e realizoi Kastriot Rexha në minutën e 40. Ndërkohë, Trepça '89 shënoi fitore tejet të rëndësishme në duel me Flamurtarin, në ndeshjen e zhvilluar në stadiumin "Fadil Vokrri", me rezultat 2-0. Golat për Trepçën '89 i shënuan Herman, në minutën e 49 dhe Diawara në minutën e 86.

IPKO SUPERLIGA

Llapi - Prishtina	1-0
KEK-u - Feronikeli	0-1
Flamurtari - Trepça '89	0-2
Ferizaj - Ballkani	1-0
Drita - Drenica	2-0
Liria - Gjilani	1-1

TABELA

1. Feronikeli	20	48 pikë
2. Prishtina	20	43
3. Llapi	20	41
4. Drita	20	29
5. Gjilani	20	29
6. Trepça '89	20	28
7. Drenica	20	27
8. Ballkani	20	27
9. Flamurtari	20	26
10. Ferizaj	20	21
11. Liria	20	20
12. KEK-u	20	1

Në xhiron e radhës takohen: Trepça '89-Liria, Drenica-Flamurtari, Gjilani-Llapi, Ballkani-Drita, Ferizaj-KEK-u, Prishtina-Feronikeli.

LIGA E PARË

Besa - Trepça	1-0
Dukagjini - Onix	0-0
Vushtrria - Kika	2-1
Istogu - Vitia	3-0
Fushë Kosova - Ramiz Sadiku	3-1
2 Korriku - Arbëria	3-0
Drenasi - Vëllaznimi	0-0
Bashkimi (K) - Vllaznia	1-1

TABELA

1. Vushtrria	18	44 pikë
2. Besa	18	38
3. Dukagjini	18	37
4. Vitia	18	34
5. Vëllaznimi	18	33
6. Onix	18	28
7. Arbëria	18	25
8. Trepça	18	24
9. Istogu	18	23
10. 2 Korriku	18	21
11. Drenasi	18	20
12. Fushë Kosova	18	20
13. Ramiz Sadiku	18	15
14. Kika	18	15
15. Bashkimi (K)	18	13
16. Vllaznia	18	12

'Dardana' përforcon pozitën e parë

Klubi i Futbollit "Dardana" e Kamenicës ka filluar sezonin pranveror në mënyrën më të mirë. Me një lojë ferr dhe korrekte dhe me një referim të shkëlqyeshëm dhe në mot të mirë, ekipi i "Dardanës" të dielën si mysafir i "Lepencit" të Kaçanikut ka arritur të fitojë me rezultat minimal 1:0.
Golin e vetëm për mysafirët, por që u solli tri pikë të reja, e ka shënuar Egzon Huruglica pas një asistimi të shkëlqyeshëm të Zogianit. Tani "Dardana", pas gjashtëmbëdhjetë xhirosh, kryeson tabelën e Ligës së Dytë B me 39 pikë, e ndjekur nga "Minatori" me 37 pikë dhe nga "Lepenci" me 35 pikë etj. (Liridon Zeqiri)

Duranti, magjik për Golden State, zhgënjejnë sërish lakersat

OAKLAND, 3 MARS - Golden State ruan kreun e renditjes në Konferencën e Perëndimit pas fitores së vështirë në fushën e Philadelphias me rezultatin 120-117. Një përballje mes dy ekipesh pretendente në konferencat përkatëse, që luftuan deri në fund për fitore dhe spektakli nuk mungoi. Ben Simmons realizoi një "triple double" për Philadelphian, me 25 pikë, 15 rebounde dhe 11 asistime, por që mbetën për statistikë. Për Warriorsin u dalluan Duranti me 34 pikë, Curry me 28 e Cousinsi me 25 pikë, një treshe që e bëri diferencën në parket. Vijon të zhgënjejë skuadra e Lakersit, që u mund 118-109 në fushën e Phoenixit, tjetër ndeshje e dobët e kalifornianëve, që i largohet gjithnjë e më shumë zonës së "play-off"-it. Vendësit dominuan në ndeshje, ku u dalluan Ayton me 26 pikë e Bookeri me 25. Për Lakersin u dalluan Jamesi me 27 pikë e 16 asistime si dhe

Ingrami me 25 pikë, por që s'mjaftuan për ta evituar humbjen. Rikthehet te fitorja skuadra e San Antonios, që mundi 116-102 Oklahomën, një përballje gjigantësh në Perëndim. Spursi dominoi në ndeshje, ku u dallua Aldridge, autor i 27 pikëve e 10 reboundeve, raporton "Telesport". Humbet edhe skuadra e Milwaukee, ekipi që kryeson renditjen në Lindje, që u mund 115-111 nga Utah Jazzi. Ndeshje ku herë udhëhiqte njëri ekip e herë tjetri, por në fund Jazzi triumfoi falë 46 pikëve të Mitchellit, një përbindësh në parket. Zhgënjen skuadra e Denverit, që u mund në fushën e vet 120-112 nga New Orleansi, duke humbur kështu ritmin e Golden States. Edhe pse vendësit u shkëputën deri në 20 pikë në pjesën e parë (JokiQ e Murray nga 20 pikë), kjo s'mjaftoi për të fituar. Për miqtë u dalluan Holiday me 29 pikë e Randle me 28 pikë e 10 rebounde.

REZULTATET

Cleveland - Detroit	93-129
Indiana - Orlando	112-117
Miami - Brooklyn	117-88
Dallas - Memphis	81-111
Philadelphia - Golden State	117-120
San Antonio - Oklahoma	116-102
Denver - New Orleans	112-120
Phoenix - Lakers	118-109
Utah Jazz - Milwaukee	115-111

SHKURT

Colorado largon Gashin

Ish-sulmuesi i Kombëtares së Shqipërisë, Shkëlzen Gashi, mbetet pa ekip, pasi Colorado Rapidsi ka njoftuar zyrtarisht se ndërprenë bashkëpunimin me sulmuesin shqiptar pas tre vjetëve bashkëpunim. "Klubi ka vendosur të heqë dorë nga Shkëlzen Gashi. Duam ta falënderojmë Shkëlzenin për shërbimet e tij gjatë këtyre tre vjetëve dhe i urojmë atij gjithë të mirat", thuhet në njoftimin e Colorados. Gashi në tre sezone me Coloradon ka luajtur në total në 68 ndeshje të kampionatit, duke shënuar 14 gola, 10 vetëm gjatë sezonit të parë.

Federeri fiton titullin e 100 në Dubai

Roger Federeri ka fituar titullin e 100 në karrierë pas suksesit në turneun e Dubait, 6 600 ditë pas titullit të tij të parë, që e ka fituar në Milano në vitin 2001. Tenisti zviceran, tashmë 37-vjeçar dhe fitues i 20 titujve Grand Slam, mundi grekun Stefanos Tsitsipas 6-4, 6-4 për ta rrumbullakosur numrin e trofeve të fituar në një karrierë të jashtëzakonshme. Federeri është tenisti i dytë pas amerikanit Jimmy Connors që arrin 100 tituj në karrierë. Connors ka fituar 109 tituj.

Ramosi: Ndaj Messit bëra një ndërhyrje të saktë

Kapiteni i Real Madridit, Sergio Ramos, bëri një tjetër gjest agresiv ndaj Lionel Messit. Por, mbrojtësi spanjoll ka mohuar se ndërhyrja e tij me krahun hapur ndaj kapitenit të Barcelonës ishte e qëllimshme, edhe pse pamjet mund të tregojnë diçka tjetër. "Bëra një ndërhyrje të saktë. Nuk bëra asnjë gjest të qëllimshëm, por ai e mori keq dhe reagoi në atë mënyrë. Megjithatë, gjithçka mbetet në fushë. Asnjë problem mes nesh", ka thënë Ramosi.

Guardiola e dëshiron Thiagon te City

Manchester City pritet të përforcohet edhe në afatin kalimtar të verës. "Mirror" ka zbuluar se trajneri Pep Guardiola u ka kërkuar drejtuesve të klubit ta transferojnë futbollistin e Bayern Munchenit, Thiago Alcantara. Guardiola ka punuar me mesfushorin spanjoll edhe në kohën që ishte te Bayerni dhe Barcelona, kurse tash e sheh si zëvendësim ideal për Fernandinhon.

Interi, gati ta rikthejë në fushë Icardin

Interi ka arkivuar një humbje të dhimbshme ndaj Caglarit, ku tashmë e sheh veten edhe poshtë kuqezinjve të Milanit në renditje. Në shtëpinë zikaltër pritet të jetë një javë e rëndësishme për sa i përket çështjes Mauro Icardi. Cikli i terapisë ka përfunduar për ish-kapitenin e Interit dhe ditën e mërkurë sulmuesi do të jetë përballë Spalettit dhe doktor Volpit. Ky i fundit është marrë me gjendjen e argjentinasit këtë kohë. Sipas asaj që raporton "Gazzeta dello Sport", gjithçka varet shumë nga dëshira e Icardit, nëse ai është gati të rifillojë me grupin, atëherë do të thirret në skuadër që për ndeshjen me Eintraktin e Frakfurtit në Evropa Ligë. Mesa duket Interi do ta bëjë hapin e parë për ta zhbllokuar situatën dhe Icardit i ngelet në dorë të vendosë nëse do të kthehet në grup apo do të vazhdojë me këtë strategji. Në sfond qëndron edhe situata e ripërtëritjes së kontratës. Interi po mendon të bëjë një ofertë zyrtare për rinovimin e tij me shtatë milionë euro në sezon, plus bonuse.

Autor: GAZMEND MORINA

SHTET NË EVROPË
PASION PËR T'U DEHUR ME ETER
KËSTI BANKAR PËR KTHIMIN E KREDISË
MASHKULLI I ROSËS / DAFINË (shq.)
DY BASHKË-TINGËLLORE
SHKOP I BILARDOS
RAVENA
PARAARDHËSI YNË
KËNGËTARE E NJOHUR SHQIPTARE
EPOKA E RE
BETIM

AKTORJA AMERIKANE NË FOTO 1 (shqip.)
BASHKËTING. / ZIFT

SHKRETËTIRA MË E THATË NË BOTË / BLETËRRITËS
PLAKË / LLOJ VETURE RUSE

QYTET NË KOSOVË / KLUB FUTBOLLI ITALIAN
QYTET I VJETËR NË KOSOVË

ÇMENDJE (bised.)
MODELJA SHQIPTARE FEJZULLAI / VEPËR E JOSIP RELËS

AMERICA ONLINE
ISTRES I TURPËRUAR (krah.)
LIDHJA E QELIZAVE TË NJËLLOJTA / KËNGËTARJA ..... TAKE
RENE RITA / ENË QELQI E RRUMBULLAKËT ME GRYKË TË GJERË E ME KAPAK

EPOKA E RE
BREJTËS I VOGËL / BASHËTING.
ISH PRESIDENTI SHQIPTAR RAMIZ .... / SIMBOL I FESË MYSLIMANE (shq.)
SHTRESË, PALË / AKTORI ÇELAJ

VETURAT, AUTOMJETET
LUMË NË TIRANË / TEFTA TASHKO
DËSHTIM I LINDJES SË FËMIJËS
AJKA E QUMËSHTIT
ELEKTRODË E POLIT POZITIV NË NJË BURIM RRYME (sh.shq.)
ZIANE ORGANIZAT. NATIONAL OHIO
JO I BARDHË

RASA E PARË E LAKIMIT, EMËRORE (gram.) / KËPUCË PËR RRËSHQITJE MBI AKULL (sh.shq.)
FALJA FETARE QË BËJNË DISA HERË NË DITË MYSLIMANËT

KUSAR
DAULLE
DIREK / SHKENCA MBI PAQEN
DRU QË PËRDORET PËR VEGLA MUZIKORE / ILION LIKA

ZANORE
HIT NGA ALTUNA SEJDIU / SHENJA QË PARALAJMËRON DIÇKA
MIRË DE; NË RREGULL (bised.) / SHTET FEDERAL NË SHBA / KAFSHË PËR NGARKESË E VISEVE TË AMERIKËS JUGORE
GAZ PËR PASTRIMIN E PLAGËVE (shq.) / TURK I VJETËR

FUTBOLLISTI FRANÇESKO (ROMA)
UMA REDFORD / EMËR MASHKULLI MYSLIMAN
I DËRGUARI SPECIAL PËR ZGJIDHJEN E NJË KONFLIKTI

INDIAN GEOPHYSICAL UNION
THIRRJE QË I BËHET TURMËS
BASHKËTING. / KALORËS MESJETAR
LLOJ REVOLEJE / DEGË E MEKANIKËS
AUSTRIA / DY BASHKË-TINGËLLORE
ZANORE / ENDE

HIJESHI, BUKURI QË TË BËN PËR VETE (bised.)
QENGJ I BUTË / MIMOZA AHMETI
NOTË MUZIKORE / KAMBANË E VOGËL (sh.shq.)
SUPER MODELJA KANADEZE JESSICA .... / ERBIUM

ABEDIN REXHA
ZVOGËLIM I TEPËRT (sh.shq.) / BASHKËTING.
KLINT ISTVUD / GJAKATAR

QYTET I YNI NË MAL TË ZI
DRY / AKTORJA HOLLIVUDIANE NË FOTO 2 ..... WATTS
PRODUKT I QUMËSHTIT / RRALLË (Lat.)

NATRIUM
HOV, VRULL / SËMUNDJE E RËNDË NGJITËSE
KËNGËTARJA VALENTINA / PARADHËNIA

ZANORE
YNDYRË PËR FYTYRË / DETERGJENT PËR DUAR
SHTET NË AZI (pashq.) / TË HOLLA

PATRIOTI ... KUKA
VEÇORIA THELBËSORE E NJË SENDI / ZANORE
IPSVICH / SHKRIMTARI MEKULI

SHTET NË AFRIKË
ZË ME DORË A ME DIÇKA TJETËR / LITËR, NIKEL
"LETONIA" / KA, DEM
SHKRONJË GREKE

INSTITUTE PUBLIC ENTERPRISE
NJOLLË (sh.shq.) / ALESANDRO NESTA
SELEN / NORA ISTREFI

EPOKA E RE
NJË PLANET NË SISTEMIN DIELLOR / ZANORE
FUSHËBETEJË (sh.shq.) / BASHKËTING.

I NJËZËSHËM
PJESË E SYRIT

ZGJIDHJA E FJALËKRYQIT: MERIL STRIP, B, ATAKAMA, LOKE, BLETAR, KLINA, TRANIM, ARITA, AO, I, INDI, RR, MI, ALIA, KAT, MAKINAT, LANA, NOMINATIV, NAMAZI, PIRAT, TRA, ABANOZ, A, INATI, ANI, OZONI, TOTI, UR, KOLORADO, IGU, APEL, Z, TT, A, E, NUR, MANAR, DO, STAM, AR, MINIMIZIMET, KI, TIVAR, KATINAR, KOS, NA, ELAN, RAMA, A, KREM, KATAR, OSO, TIPARI, I, MALI, KAP, LE, IPE, LARAT, SE, URAN, ARENAT, UNANIM, IRIDA.

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
Ministarstvo Trgovine i Industrije - Ministry of Trade and Industry

Në pajtim me dispozitat e Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligji Nr. 03/ L -149, Rregullore Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovë, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë shpallë:

REKRUTIM

Institucioni: Ministria e Tregtisë dhe Industrisë

Departamenti për Rregullimin e Tregut të Naftës

Titulli i vendit të punës: **Zyrtar i Lartë për cilësinë e naftës dhe produkteve të naftës**
Koeficienti / 8
Nr. i Referencës: MTI/ 4
Numri i zyrtarëve që do të pranohen: 1
Vendi: Prishtinë **Data: 04/03/2019**

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Harton planet e punës vjetor të përcaktuar në bazë të objektivave të njësisë dhe jep rekomandime lidhur me realizimin objektivave të njësisë
- Përgatit të dhënat sipas planifikimit të buxhetit të Departamentit për rregullimin e Tregut të Naftës
- Sipas nevoje merr pjesë në komisionin për shqyrtimin e kërkesave të subjekteve afariste
- Përcjell standardet e BE-së dhe ndërkombëtare lidhur me cilësinë e naftës dhe derivateve të saj.
- Në vazhdimësi i raporton drejtorit të DRRTN, për aplikimin e standardeve gjegjësisht për aplikimin e tyre.
- Sipas nevoje mund të propozohet si anëtar i grupit punues, nga Drejtori i DRRTN, për hartimin e akteve normative si ligjore dhe nënligjore, të cilat dalin nga fushë veprimtaria e institucionit.
- Kryen çdo detyrë tjetër në fushën profesionale specifike në përputhje me ligjet dhe rregulloret aktuale të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe.

Kualifikimet për këtë vend të punës:

- Diplomë universitare: Ekonomik, Juridik, Kimi, Teknik;
- Minimum 3 vite përvojë pune profesionale;
- Njohuri të thellë dhe të specializuar në fushën e tregut te naftës, të fituar përmes arsimimit universitar dhe trajnimeve përkatëse;
- Njohuri të ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme;
- Shkathtësi në komunikim planifikim të punës dhe udhëheqje të ekipit;
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- Shkathtësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Excel, Power Point, Access);

Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim:

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës , të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, kanë shkollimin e lartë dhe kanë aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave.

Kohëzgjatja e emërimit:

Nëpunësi i karrierës (përhershëm) Periudha provuese .Dymbëdhjetë (12) muaj.

Data e mbylljes së konkursit:

18/03/2019

Paraqitja e kërkesave

Formularët për aplikim mund të merren në recepcion të MTI-së, ose të tërhiqen nga *web* faqja e MTI-së, ku është bërë edhe shpallja e konkursit , në adresën **www.mti-ks.org** dhe dorëzohen në Divizionin e Burimeve Njerëzore, çdo ditë pune nga ora 8:00 -16:00 deri më**: 18/03/2019.** Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në nr. tel. 038-200 36-578.

"*Shërbimi Civil i Republikës së Kosovës, ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë".*

"Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcionalë organet e shërbimit civil të administratës publike,qendrore dhe lokale,siç specifikohet në Nenin 11, paragrafi 3të Ligjit Nr..03/L-149 mbi shërbimin Civil të Republikës së Kosovës"

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen.

Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuara,vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
Ministarstvo Trgovine i Industrije - Ministry of Trade and Industry

Na osnovu odredaba Zakona o Civilnoj Službi Republike Kosovo, Zakon br. 03/L -149, Uredbe Br. 02/2010 o Procedurama Regrutovanja u Civilnoj Službi Republike Kosovo, Ministarstvo Trgovine i Industrije, objavljuje:

REGRUTOVANJE

Institucija: Ministarstvo Trgovine i Industrije

Odeljenje za Regulaciju Tržišta Nafte

Naziv radnog mesta: **Viši službenik za kvalitet nafte i naftnih derivata**
Koeficijent / 8
Referentni Br: MTI/4
Broj zvanićnika koji će biti prihvaćeni: 1
Mesto: Priština **Datum: 04/03/2019**

Dužnosti i odgovornosti:

- Izrađuje godišnje planove rada utvrđene na osnovu objektiva jedinice i daje preporuke u vezi sa postizanjem objektiva jedinice.
- Priprema podatke u skladu sa planiranjem budžeta Odeljenja za Regulaciju Tržišta Nafte.
- Prema potrebi učestvuje u komisiji za razmatranje zahteva poslovnih subjekata.
- Prati EU i međunarodne standarde u pogledu kvaliteta nafte i njenih derivata.
- Dosledno izveštava direktoru ORTN-a o primeni standarda.
- Prema potrebi može se predložiti kao član radne grupe, od strane direktora ORTN-a, za izradu normativnih akata kao što su zakonski i podzakonski akti, koji proizilaze iz oblasti delatnosti institucije.
- Vrši i druge poslove u specifičnoj profesionalnoj oblasti koji se s vremena na vreme mogu razumno zahtevati.

Kvalifikacije za ovo radno mesto:

- Univerzitetska Diploma: Ekonomski, Pravni, Hemijski, Tehnički Fakultet;
- Najmanje 3 godine profesionalnog radnog iskustva;
- Duboko i specijalizovano znanje iz oblasti tržišta nafte, stečeno kroz univerzitetsko obrazovanje i relevantnu obuku;
- Poznavanje važećih zakona i propisa;
- Veštine u komuniciranju, planiranju rada i vođenje tima;
- Istraživačke, analitičke, procenjivačke veštine i formulisanje profesionalnih saveta;
- Računarske veštine u aplikacionim programima (Word, Excel, Power Point, Access);

Uslovi za učešće u regrutovanju:

Pravo apliciranja imaju svi građani Republike Kosovo koji su potpuno sposobni da deluju, imaju visoko obrazovanje i imaju profesionalnu sposobnost za obavljanje dužnosti.

Trajanje imenovanja:

Službenik karijere (trajni). Probni period: dvanaest (12) meseci.

Datum zatvaranja konkursa:

18/03/ 2019

Podnošenje zahteva

Obrasci za apliciranje preuzimaju se na recepciji MTI-a, ili se preuzimaju sa web stranice MTI-a, gde je objavljen konkurs, na adresi **www.mti-ks.org** i podnose se Diviziji za Ljudske Resurse, svakog radnog dana od 8:00 **-**16:00 časova do**: 18/03/2019.**

Za detaljnije informacije možete kontaktirati na tel. 038-200 36-578.

"*Civilna Služba Kosova pruža jednake mogućnosti zapošljavanja svim državljanima Kosova i pozdravlja aplikacije svih osoba muškog i ženskog pola svih zajednica na Kosovu".*

"Nevećinske zajednice i njihovi pripadnici imaju pravo na pravedno i proporcionalno predstavljanje u organima civilne službe centralne i lokalne javne uprave kao što je definisano u Članu 11, stav 3 Zakona Br. 03/L-149 o Civilnoj Službi Republike Kosovo"

Nepotpune aplikacije i podnesene posle krajnjeg roka neće biti prihvaćene.

Zbog velikog broja primljenih zahteva, samo kandidati izabrani na užem spisku će biti kontaktirani.



>> SHPALLJE TË VOGLA <<

▶ Dashnor Begaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I -VIII shf "Deshmoret e Zhurit" Zhur

▶ Sejfulla Jahaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl VI - IX shf "Zenun Çoçaj" Gjonaj

▶ Limin Saramati shpall shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shf "Leke Dukagjini" Prizren

▶ Leotrim Rexhaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl VI - IX shf "Dëshmorët e Kabashit" Korishë

▶ Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

▶ Shitet banesa në Lakërishte përballë Procredit Bankës, hyrja e parë kati i 9 banesa ka 50m2 me dokumentacion të rregullt, çmimi52 000€. Për info 044/672-439.

▶ Lëshohet me qira banesa në lakërishte afër Procredit bankës është e mobiluar 50m2 për një çift çmimi është 220€. Për irno 044/672-439.

▶ Shes banesën hyrja e 7 mbi kurriz te banesat e gjelbërta përball shkollës "Xhemajl Mustafa" e rinovuar tërësisht. Banesa ka 82 metra katror. 3 dhoma, sallon, shpajz dhe ballkon + taras me shfrytëzim. Çmimi 75000 Euro me para te gatshme, por bej edhe ndërrim me banesë me të vogël në Prishtinë ose banesë më të madhe në Fushë Kosovë sipas marrëveshjes. Numri kontaktues: 044 672 439

Shes truallin prej 36 arë në fshatin Besi; 150 metra nga magjistralja Prishtinë-Besianë. Trualli ka gjithë infrastrukturën e nevojshme dhe është shumë i përshtatshëm dhe për banim kolektiv.
Tel. 044-413-197, wiber: 045-198-095.

▶ Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

▶ Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

▶ Kërkoj kamerier me përvojë pune. Gjendemi në Prishtinë te sheshi "Zahir Pajaziti". Nr: kontaktues- 045-999-985.

▶ Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT

MINISTARSTVO ZA KULTURU, OMLADINU I SPORTA/ MINISTRY OF CULTURE YOUTH AND SPORTS

DEPARTAMENTI I FINANCAVE DHE SHËRBIMEVE TË PËRGJITHSHME / DEPARTMENT OF FINANCES AND GENERAL SERVICES / DEPARTMAN I FINANSIJA I GENERALNIH USLUGA

DIVIZIONI I BURIMEVE NJERËZORE / DIVISION OF HUMAN RESOURCES / DIVIZIJA LJUDSKIH IZVORA

Bazuar në Ligjin për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, L. nr. 03/L-149, dhe Rregulloren nr. 02/2010, për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit shpall:

KONKURS

Titulli i punës: Zyrtar për Buxhet dhe Financa
Kategoria funksionale/ Koeficienti 8
Numri i referencës: 10/2019
I përgjigjet: Udhëheqësit të Divizionit per Buxhet dhe Financa
Vendi: Prizren
Detyrat dhe përgjegjësitë: Nën mbikëqyrjen e Udhëheqësit të Divizionit për Buxhet dhe Financa

Detyrat dhe përgjegjësitë:

1. Harton planet e punës në pajtim me mbikëqyrësin për zbatimin e detyrave të përcaktuara në bazë të objektivave dhe jep rekomandime lidhur me realizimin e këtyre;
2. Udhëheq grupet punuese për përgatitjen e buxhetit dhe ndihmon njësitë tjera organizative të ministrisë për planifikimin dhe realizmin e buxhetit;
3. Analizon dhe vlerëson propozimet buxhetore dhe bënë ekzaminimin e tyre duke shqyrtuar korrektësinë, saktësinë dhe tërësinë si dhe kontribuon në përgatitjen e buxhetit përfundimtar për njësinë buxhetore;
4. Ofron këshilla dhe udhëzime, përfshirë trajnime për stafin lidhur me përgatitjen dhe shpenzimin e buxhetit si dhe politikat dhe procedurat financiare;
5. Monitoron shpenzimet e buxhetit gjatë gjithë vitit dhe rekomandon rialokimin e buxhetit kur është e nevojshme si dhe përgatitë raporte mbi shpenzimet buxhetore;
6. Siguron disponueshmërinë dhe alokimin e buxhetit në përputhje me procesin e fillimit të çdo aktivitetit dhe buxhetin e planifikuar;
7. Zhvillon dhe zbaton politikat, procedurat dhe praktikat financiare dhe operative të cilat lehtësojnë dhe mbështesin menaxhimin financiar;
8. Kryen edhe detyra tjetër në përputhje me ligjet dhe rregulloret të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe nga mbikëqyrësi ;

Shkollimi i kërkuar, përvoja, aftësitë dhe karakteristikat personale:

- Diplome universitare, drejtimi ekonomik, financa, biznes apo të ngjashme, 2 vite pervoje pune profesionale;
- Njohuri dhe përvojë në fushën e në fushën e buxhetit dhe financave;
- Shkathtësi në komunikim planifikim të punës dhe udhëheqje të ekipit;
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- Aftësi për përmbushje të detyrave dhe punëve nën presion;
- Shkathtësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel, Power Point, Access, Internetit);

Procedurat e konkurrimit:

Konkursi është i hapur për të gjithë kandidatët e MKRS-së

Kohëzgjatja e emërimit: Emërimi është me afat të pacaktuar.

Data e mbylljes së konkursit: Konkursi është i hapur pesembedhjete (15) ditë pas ditës së shpalljes.

Data e fundit e aplikimit është: 18.03.2019

Aplikacionet e dërguara nëpërmjet postës, me pullë postare, në ditën e fundit të shpalljes, konsiderohen të vlefshme.

Paraqitja e kërkesave: Aplikacioni merret dhe dorëzohet në zyrën 27 të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Sheshi "Nëna Terezë" nr. 44. Për informata shtesë kontaktoni në numrin 038211449 (apo në ueb-faqen http://www.mkrs-ks.org/).

MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT

MINISTARSTVO KULTURE, OMLADINE I SPORTA/ MINISTRY OF CULTURE YOUTH AND SPORTS

DEPARTAMENTI I FINANCAVE DHE SHËRBIMEVE TË PËRGJITHSHME / DEPARTMENT OF FINANCES AND GENERAL SERVICES / DEPARTMAN I FINANSIJA I GENERALNIH USLUGA

DIVIZIONI I BURIMEVE NJERËZORE / DIVISION OF HUMAN RESOURCES / KADROVSKA DIVIZIJA

Bazirajući se na Zakon za Civilne Usluge Republike Kosova, L. br. 03/L-149, i Pravilnik br. 02/2010, o Procedurama Regrutacije u Civilnim Uslugama Republike Kosova Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta objavljuje:

KONKURS

Naziv rada: Službenik za Budžet i Finansije
Funkcionalna kategorija/ Koeficienat 8
Broj referencije: 10/2019
Odgovoran je: Rukovodiocu Divizije za Budžet i Finansije
Mesto: Prizren
Zadaci i odgovornosti: Pod nadzorom Rukovodioca Divizije za Budžet i Finansije

Zadaci i odgovornosti:

1.Uređuje planove rada u saglasnosti sa nadzornikom za sprovođenje zadataka, određenih na osnovu objektiva i daje preporuke u vezi njihove realizacije;

2.Rukovodi radnim grupama za pripremu budžeta i pomže ostalim organizativnim jedinicama ministarstva za planiranje i realizaciju budžeta;

3.Analizira i vrši procenjivanje budžetskih predloga i vrši njihovu kontrolu, razmatrajući korektnost, tačnost i celovitost kao i doptinosi u pripremi završnog budžeta za budžetsku jedinicu;

4.Nudi savete i uputstva, obuhvatajući i podučavanje stafa u vezi pripreme i potrošnje budžeta kao i o finansijskim politikama i procedurama;

5.Nadzire troškove budžeta tokom cele godine i i preporučuje preusmeravanje budžeta kada je to potrebno kao i priprema izveštaje o budžetskim troškovima;

6.Obezbeđuje raspoloživost i usmeravanje budžeta u podudarnosti sa procesom počinjanja svake aktivnosti i planirani budžet;
7.Razvija i sprovodi finansijske i operativne politike, procedure i prakse, koje olakšavaju i podržavaju finansijsko upravljanje;
8.Izvršava i ostale zadatke u podudarnosti sa zakonima i pravilnicima, koji mogu da se zahtevaju, na raložan način od nadzornika, s vremena na vreme;

Zahtevano obrazovanje, iskustvo, sposobnosti i lične karakteristike:

- Univerzitetska diploma, pravac ekonomije, finansija, buznisa ili slično, 2 godine profesionalnog rada;
- Znanje i iskustvo iz oblasti budžeta i finansija;
- Sposobnost u komuniciranju, planiranju rada i rukovođenja ekipom;
- Istraživačka, analitička i sposobnost za procenjivanje i formulisanje profesionalnih preporuka i saveta;
- Sposobnost za ispunjavanje zadataka i rada pod pritiskom;
- Sposobnosti na kompjuteru za aplikovanje programa (Word, Excel, Power Point, Access, Interneta);

Procedure za konkurisanje:

Konkurs je otvoren za sve kandidate MKOS-a

Vremensko trajanje imenovanja: Imenovanje je na neodređeno vreme.

Datum zatvaranja konkursa: Konkurs je otvoren petnaest (15) dana nakon objavljivanja.

Zadni datum za aplikovanje je: 18.03.2019

Aplikacije poslate preko pošte, poštanskom markicom, na zadnji dan objave, smatraće se validnim.

Podnošenje zahteva: Aplikacija se uzima i predaje u kancelariji br. 27 Ministarstva Kulture, Omladine i Sporta, Trg "Majka Tereza" Br. 44. Za dodatne iformacije kontaktirajte br. 038 211 449 (ili web-stranicu http://www.mkrs-ks.org/).

Në prag të 5, 6, 7 dhe 8 Marsit ditëve të lavdisë dhe sakrificës së familjes Jasharaj, ditës së mësuesit dhe ditës së nënës, për kandidat/etë interesuar për regjistrim të marrjes së patentë shoferit ofroj lehtësim financiar. **Vijimi i orëve praktike dhe teorike për 20 ore nga 200.00 Euro në 150.00 Euro.**

Interesimi i juaj - përkushtimi im. Eksperienca ime - suksesi i juaj. Afati i paraqitjes prej 01.03. 2019 deri më 10.03.2019.